Dr. Shk. HASAN B. LUÇI

DIPLOMATI ZBULUES RRËFEN

RRËFIM AUTOBIOGRAFIK

BOTIMET TOENA

Dr. Shk. Hasan Luçi

Diplomati zbulues
RRËFEN

rrëfim autobiografik

BOTIMET TOENA
Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Redaktore letrare: Besa Vila
Përkujdesja grafike: Rogen Alushani

ISBN 9789928961068

©AUTORI & BOTIMET TOENA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA
Rr. "M. Gjollesha", nr. 71, Tiranë 1023
ose K. Postare 1420
Tel.: +355 67 70 70 884
botimet.toena@gmail.com
toena.porosionline@gmail.com
https://toena.al

Përmbajtja e lëndës

Dy fjalë jetëshkrimi 11
Parathënie 15
Si u përfshiva në shërbimin e zbulimit politik shqiptar 25
Hapat e parë në punën zbuluese 37
Udhëtimi Tiranë - Moskë 44
Fushat e studimit në fakultetin D të zbulimit 49
Përshtypje nga jeta në Bashkimin Sovjetik 62
Përgatitja ideopolitike, zbuluese dhe diplomatike në Fakultetin D të zbulimit në Moskë 67
Përgatitja ideopolitike, zbuluese e diplomatike në Fakultetin D të zbulimit në Moskë 70
Pritja e delegacionit të Partisë së Punës së Shqipërisë me në krye Enver Hoxhën 79
Vrojtime të përgjithshme nga jeta në Bashkimin Sovjetik 79
Provimet dhe diplomimi në fakultetin D të zbulimit 82
Kthimi në atdhe 83
Veprimtaria ime zbuluese në qendër të zbulimit (1958 – 1961) 85
Përballje me këshilltarin sovjetik, zbuluesin Stimasjev 91
Shërbimi i parë zbulues në Europën Perëndimore 98
Projekti për të vajtur zbulues në legatën tonë në Athinë 101
Në grupin shoqërues të Hrushovit gjatë vizitës në Shqipëri 102
Shoqërues i Moris Torezit në 1960 103
Veprimtaria si zbulues jashtë shtetit në dallgët e Luftës së Ftohtë 107
Emërimi dhe shërbimi në përfaqësinë tonë në Paris (1961-1968) 110
Puna zbuluese në mjedisin e kundërshtarit në Perëndim 112
Përpunimi zbulues i mërgatës politike shqiptare 114
Veprimtaria në terrenin armik 114
Balli Kombëtar dhe rrymat e tij - objekt i punës sonë zbuluese 118
"Shqiponja", një haset i rrallë zbulues 118
"Shpëtimi" – një atdhetar i rrallë 124
"Beu" 125
Ballisti Hasan Lepenica 127
Fajtori pa faj 128
Studime dhe tërheqje të reja bashkëpunimi falë punës sime 131
Dy vëllezërit malësorë nga veriu 131
"Muji" dhe "Shtiza" nga familje bajraktarësh 133
"Liqeni" 136
"Pali" 137
"Boga" 138

Organizata Kombëtare Lëvizja e Legalitetit 139
(OKLL)- Lëvizja zogiste 139
"Luftëtari" (Isuf (Cufe) Mullai) 139
"Viroi"(Andon Konomi) 144
"Syri" (Zenel Çami) 146
"Todi" 152
"Bredhi" 156
"Luzi" (Halit Ceruni) 159
Miku "Suli" 160
"Pullat" e ngjitura Nezir dhe Ylli Spahisë 161
Provokacioni me kandidatin "Pëllumbi" 163
"Zekthi" 167
Sali Doçishti dhe Ahmet Zogu 168
Organizata "Blloku Kombëtar Indipedent" 170
Bashkëpunimi me Ismail Vërlacin 170
"Fieri" 175
"Korabi" 179
"Murga" 182
Miku "Bajraktari" 183
"Kiri" 184
Synimi për ta futur në kurth Ndue Pjetër Gjonmarkajn 185
Mbrojtja e kolonive shqiptare nga veprimtaria armiqësore dhe agjenturore antishqiptare 190
Miku "Atdhetari" 191
Miku "401" 192
Atdhetari Muharrem Ymeraj 194
"Rina" 195
"Historiani" 195
Kalem Golemi 197
Takimet me Agllai Zoton 199
Kutitë postare të ndërlidhjes me bashkëpunëtorë në vende të treta 201
Miku Jorgo Kuruni 201
Miku Duro Shehu 203
Atdhetarja Maria Çobani 204
Mërgata kosovare dhe puna jonë për mbrojtjen e saj si problem mbarëkombëtar të trojeve tona shqiptare 205
"926-ta" 206
Ia vlen të përmend këto raste mbi të dhënat e tij: 209
Çifti bashkëpunëtorë-shqiptaro-kosovar 211
"925-ta" dhe grupi i tij miqësor 214
Miku "Sopoti" 215

Miku "Zymbyli" 215
Miku "Shqiptari" 216
Miku "84" 216
"Triumfi" 217
Miku M.K. 218
Miku R.K. 218
"Doktori" 218
Dy kushërinjtë gjakovarë 221
Mbrojtja e trojeve shqiptare jashtë shtetit shqiptar 222
"Linguisti" 225
"Presheva" 226
Miku "Rapsodi" 229
Mbrojtja e studentëve, pasuniversitarëve dhe qytetarëve shqiptarë në Francë 231
Një veprim i pahijshëm në një kafene në Iagjen 236
Sen-Mishel 236
Amnistia-thikë me dy presa 239
Hasan Spahia vate si çjapi te kasapi 239
Rustem Shehu 241
Zagoriti Çarka 242
Bajram Hallaqi 242
Paralajmërime për parandalime ngjarjesh në Atdhe 243
Paralajmërimi për revoltën e Spaçit 243
Avdul Banushi në bazën e Shallvareve në Tiranë 244
Paralajmërimi për arratisjen e bujshme nga Liqeni i Pogradecit 245
Rrjeti agjenturor i UDB-ës në veprimtari përmes Lumit të Bunës 247
Agjentura armike në objektin kryesor ushtarak në Shkodër 248
Të dhëna për një kanal ndërlidhjeje të UDB-ës përmes diversantëve
Jugosllavi-Shkodër-Blloku i udhëheqjes në Tiranë 249
Të dhëna për një agjent në BP të PPSh-së dhe shifrën tonë 250
Të dhëna për kardiologun si agjent i UDB-ës dhe CIA-s 252
Të dhëna për lëvizjet e udhëheqësve tanë jashtë shtetit 253
Ngjarje të veçanta 253
Ngjarja e Durrësit me Beqir Ballukun dhe lufta e Qipros në vitin 1974 253
Përpjekjet e bashkëpunëtorit tradhtar për ta rimarrë në lidhje me porosi të UDB-ës 257
Telefonatat e Nesti Kopalit 258
Rasti i familjes Popaj – provokacion i qëllimshëm 260
Zbulimi, përpunimi dhe parandalimi i veprimtarisë së mprehtë terroriste-diversioniste i mërgatës
politike shqiptare dhe zbulimeve armike kundër vendit tonë 261
Plani operativ për kërcënime të ndryshme terroristëve 265
Përgatitja për të përballur ndonjë agresion të mundshëm 269

Kryetar i degës VII (dega e antiterrorizmit në zbulimin politik)..... 274
"Gruri"..... 276
"Anka" 277
"Bjeshka" 279
"Baroti" 280
"Plumbi" 281
"Djali" 283
Bashkimi i degës VI dhe VII..... 285
Përpunimi, zbulimi dhe fundi i bandës së Xhevdet Mustafës 290
Takimi me Sofie Bajramin..... 305
Veprimtaria zbuluese kundër UDB-ës 307
Pse u dyshua se "Besimi" ishte agjent i dyfishtë dhe provokator?..... 307
Kosovari Ali Hoxha..... 309
"Kapllani"..... 310
Detyra të veçanta..... 311
Me grupin e të rinjve të kolonisë shqiptare në Francë..... 312
Mbrojtja e udhëheqësve të Partisë e të Shtetit në Paris..... 313
Shërbime jashtë shtetit në vite 317
Një javë në Stamboll..... 317
Me shërbim në Sofje..... 319
Jugosllavia vend tranzit me avion për në Lindje e Perëndim..... 319
Në Nju-Jork, në zemër të imperializmit amerikan..... 319
Me shkrimtarin Nasho Jorgaqi: Bruksel-Paris..... 320
Shërbime brenda vendit..... 322
Shërbimi në Konispol te piramida 69 322
Shërbim në Kukës e Tropojë 325
(Bajram Curri–Valbonë-Cerem-Markovc-Lugu i Zi)..... 325
Disa dështime në veprimtarinë operative..... 330
Dështimi për rekrutimin e K. Xh-së..... 331
Kandidati "Luma"..... 334
Personi në studim Skënder Zogu 336
Kandidati Qazim Premti..... 338
Kandidati " Çelësi "..... 339
I burgosuri R. A. 339
Kandidati K. H. 340
Kandidati D. S. 341
Kandidati Lekë Arapi 346
Personi në studim Xhelal Staravecka 347
Telefonatat në legatë nga Ndue Lala 348
Dështim me bp "Kollosi"..... 349

Dështime në fushën e ndërlidhjes me bashkëpunëtorët 350
Disa shaka pa kripë në rrugë private, partie e shtetërore ndaj meje 351
Letra "vigjilente" 351
Paralajmërimi diplomatik 352
Një "qortim" nga Enver Hoxha 352
Çelësi në kasafortë 355
Kërkesa për studimet universitare 355
Tema e sesionit shkencor mbi mërgatën politike 356
Pakënaqësi e një zbuluesi kundër meje 356
Projekt transferimi në Universitetin e Tiranës 357
Sinqeriteti i drejtorit 357
Thirrja në sektorin e organizatës së PPSh-së në KQ 359
Thirrja e papritur në KQ të PPSh-së 360
Kthim i vonuar në Atdhe 361
Shakaja me dosjen time personale 362
Ngjarje me ministrin e Brendshëm Feçor Shehu 363
Plani për arrestimin e Nesti Nases, ish-ministër i Jashtëm 365
Përpjekje për të mbrojtur të pafajshmin, Ymer Berberi 367
Kërkesa për denoncim të veprimeve armiqësore të Kadri Hazbiut 368
Grupi që përgojoi Enver Hoxhën 369
Një pakujdesi që i kushtoi punës zbuluese 371
Një dredhi dhelparake 371
Mosrizgjedhja sekretar i organizatës bazë të partisë 373
Një "cen" në biografi? 374
Një grindje për mustaqet e Çelos 375
Një gënjeshtër me bisht 376
Qarkullimi im i motivuar keq 377
50 vjetorin e festova në familje 379
Një ceremoni zyrtare pa kokë 380
Thirrja në Komitetin e Partisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme për sqarimin e letrës anonime 380
Luftë për mbrojtjen dhe miratimin e disertacionit 383
Kërkesat për të drejtat e mia 386
Një odise tjetër për botimin e disertacionit 387
Vonesa e vizës së djalit për shërbim zyrtar jashtë shtetit 388
Pedagog në Shkollën e Lartë të Zbulimit (i quajtur Filiali) 389
Qortime gjatë punës 396
Mbrojtja nga veprimtaria e organeve sekrete franceze 397
Zbulimi i përgjimit teknik operativ francez në ambasadën tonë në Paris 397
Katedra shqipe në gjuhët lindore në Paris në shenjë të zbulimit tonë 403

Mbrojtja nga veprimtaria e zbulimeve perëndimore dhe lindore 405
Mbrojtja nga veprimtaria e gjithanshme e CIA-s 408
Zbuluesi i CIA-s në Paris–survejues i ambasadës sonë 409
Mbrojtja nga veprimtaria e zbulimit grek 410
Në zemër të Kongresit Panepirot më 1967 në Janinë 412
Përgatitje kurthi për diversantin Nikolla Plasoti 413
Mbrojtja nga veprimtaria e zbulimit italian 417
Mbrojtja nga veprimtaria e zbulimit të Vatikanit 419
Mbrojtja nga veprimtaria e zbulimit anglez (Intelixhens Servis) dhe radio Bi-Bi-Si 420
"Orioni" 421
"Miqësia" shqiptaro-turke 422
Reformat në punën zbuluese - direktiva të Enver Hoxhës 423
Largimi i zbuluesve në vitet '70-'80. 431
Të dhëna dhe mendime mbi drejtues të zbulimit e të kundërzbulimit 433
Mendime e të dhëna mbi udhëheqësit që drejtuan zbulimin 439
Mehmet Shehu u bë tabelë qitje për të bëra e të pabëra 441
Kadri Hazbiu gëzon ende mbështetje popullore 445
Hekuran Isai i përzgjedhuri i Enver Hoxhës 451
Polemika pa mbarim për vdekjen e Enver Hoxhës 452
Disa çështje të trajtuara me ministrat e brendshëm dhe KQ të PPSh-së 454
Kërkesat ndaj ministrit Hekuran Isai 454
Disa mendime mbi Hekuran Isain 455
Kërkesat ndaj ministrit Simon Stefani 458
Kërkesat ndaj Ramiz Alisë si drejtues në zbulim 459
Kërkesat ndaj ministrit të Arsimit Skënder Gjinushi 475
Polemikat mbi figurën e Ramiz Alisë 476
Polemika mbi figurën e Fatos Nanos 481
Polemikat për figurën e Sali Berishës 483
Marrëdhëniet Ramiz Alia–Sali Berisha 488
Veprimtaria e CIA në tranzicionin demokrat shqiptar 489
Qëndrimi im ndaj Enver Hoxhës 492
Përfundime 501
Libra të botuar të autorit e përkthyesit Dr. Shk. Hasan B. Luçi 510
Përkthime nga frëngjishtja 510
Botime në pritje 511

Dy fjalë jetëshkrimi

Kam lindur më 01.01.1936 në Kuç të Kurveleshit në një familje patriarkale të varfër fshatare. Jam fëmija i dytë; 4 motra e 6 vëllezër. Shtëpia në qendër të fshatit u prish nga tërmeti i vitit 1892, ndërsa shtëpia jonë, ku linda, me përmasa 15x10 m², me 2,5 m lartësi u ndërtua nga stërgjyshi, aty ku kishte stanet, në rrëzë të vargmalit të Vetëtimave, dikur ka qenë vendi paraolimpik i Zeusit, kryepërëndia pagane, që lëshonte rrufetë, por grekët e zhvendosën në Olimp, Greqi. Përjetova luftën italo-greke 1940–1941-it, midis frontit në shpellat malore. Ushtria greke na grabiti bagëtitë dhe kafshët e punës. Sapo filloi Lëvizja Nacionalçlirimtare familja jonë dhe i tërë fisi u bë bazë e ilegalëve të parë, pastaj i çetave dhe batalioneve partizane. Babanë e kërkonin italianët, kështu u detyrua të qëndronte ilegal. Babai dhe xhaxha Meto morën pjesë në aksionin për shpartallimin e postës së milicisë italiane, më 10 nëntor të 1942-it, kur Kuçi në fakt u çlirua dhe në 29 nëntor po të vitit 1942 për çlirimin e nënprefekturës së Kurveleshit. Më pas armiku bëri operacioni ndëshkimi, por nuk mundi të ngrinte sërish postat kuislinge e fashiste. Babai mori pjesë në një çetë të fshatit, u bë komandant i një çete në batalionin territorial "Ismail Haki". Mori pjesë në të gjitha betejat në jugun e vendit deri në çlirim. Kur fashistët italianë na dogjën shtëpinë, në 16 prill të vitit 1943, mua dhe gjyshen na zunë në befasi dhe aty pamë si e dogjën me benzinë shtëpinë, vathët dhe kasollet e bagëtive e të lopëve, por edhe shtrojën e qenit, ende të pazgjidhur. Nxitova ta zgjidhja sepse po i afrohej zjarri, por ndërkohë një ushtar më goditi në kurriz me qytën e pushkës. Rashë përdhe. Gjyshja ulëriti, më mori në duar dhe u ulëm në gurin, ku flinim në verë para shtëpisë. Në atë gur pamë si u dogj fshati; gjithçka. Italianët i lëshuan kuajt në arat me grurë, ku përgatitën edhe drekën, pastaj u larguan, por pasi dogjën edhe 4 shtëpitë e fisit tonë. Banorë e partizanë shikonin

nga mali gjëmën. Nuk u bë luftë, se ndryshe fashistët italianë, kuislingët e tradhtarët do të vrisnin njerëzit që kapën në befasi nëpër banesa apo rrugëve gjatë operacionit. Italia kapitulloi në shtator të 1943-it. Por, pa vonesë, po në tetor të 1943-it u bë beteja e parë me nazistët gjermanë alpinë në malin mbi Kuç, ku ishin edhe babai e xhaxhai. Aty u vranë 6 kuçiotë si edhe Heroi, Themo Vasi, nga Zagoria e të tjerë. Neve na erdhi mandata e babait, që e qamë tri ditë, por fatmirësisht ai erdhi i gjallë, me shumë përpjekje kishte shpëtuar nga rrethimi armik. Fshati ynë pësoi 8 operacione armike dhe ne mbijetuam në pyje, në male e në shpella. Fshati u çlirua, më 25 qershor të 1944-ës. Kuçi u quajt "Republika e kuqe" ose Stalingradi nga armiku gjatë LANÇ-it. Edhe turqit, në vitin 1716, e kanë quajtur gjithmonë fshat kryengritës kur dy të parët e mi, Hasan e Mehmet filluan kryengritjen në Kuç, e cila u përhap deri në Margëlliç, Çamëri, sot nën Greqi; ndërsa në 1847-ën, në kryengritjen e Tanzimatit, ishte stërgjyshi im, Sulo Luçi, kushërinjtë Nuro e Hasan Luçi. Hasani vdiq në internim në Turqi. Në 1913-ën kundër pushtuesve grekë në Janinë u vra vëllai i gjyshit tim, Hasani nga e kam marrë emrin unë, kurse gjyshi, Hamiti, u plagos rëndë në frontin Kuç - Himarë në luftë me bandat greke më 1914-ën. Hamiti u mjekua një vit në Korfuz te miqtë. Në Luftën e Vlorës më 1920, gjyshi im, Hamiti dhe i vëllai, Abazi, bashkë me shokët i mundën pushtuesit italianë dhe hynë të parët në kalanë e Kaninës. Në LANÇ Kuçi pati 235 partizanë, nga të cilët 30 vajza e gra, në brigadat dhe njësitë e vendit, përfshi Veriun; 237 kuçiotë, 29 gra e vajza në batalionin territorial që luftoi kudo në jug të vendit. Mbi 200 vajza e gra ishin veprimtare të luftës partizane, përfshi gjyshen, Veso, nënën time, Haxho, që shërbeu edhe si korriere me partizanët në bregdetin e Himarës; 50 luftëtarë në komandën e vendit. 150 luftëtarë morën pjesën në çlirimin e ish-Jugosllavisë deri në Vishegrad. Gjatë luftës u vranë 145 kuçiotë, 94 u shpallën dëshmorë, tri shoqe dëshmore, ranë dëshmorë 7 djem të vetëm, të tjerët u quajtën viktima. Armiku masakroi 34 vetë, burgosi dhe internoi 58 vetë, 25 në Greqi, të tjerë në Ventotene Itali, 8 në kampet e shfarosjes në

Dakau etj., 25 të internuar brenda vendit, shumë të plagosur, si edhe 35 vetinvalidë. Kuçi pati 103 kuadro komanduese në njësitë partizane, 134 anëtarë të PKSh, nga të cilët 13 shoqe. Kuçi në shtator të vitit 1999 u shpall "Fshat martir" nga Unioni Botëror i Vendeve Martire të Paqes. Pas çlirimit, në përpjekje me bandat terroriste–diversioniste, ranë dëshmorë 6 kuçiotë, dhe 2 dëshmorë ranë në provokacionet greke në 1949-ën.

Pas çlirimit filloi rimëkëmbja e ekonomisë dhe rindërtimi i banesave, ku morëm pjesë edhe ne fëmijët. E fillova shkollën fillore në shtator të vitit 1944, dy orë larg, shkoja e vija nëpër pyje, përrenj e kodra. Në 1949-ën, shkova vullnetar në hekurudhën Peqin-Elbasan dhe punova si korrier i shtabit të vullnetarëve të rinisë. Në vitin 1949 fillova shkollën 7 - vjeçare 2.5 orë larg në fshat qendër, ku rrija një javë vetëm në shtëpinë e rindërtuar pas çlirimit, duke marrë ushqimin nga shtëpia. Mora pjesë në grupin e teatrit dhe recitimeve, në gazetën e murit dhe dy vite më zgjodhën komandant të çetës së pionierëve të shkollës. Mora pjesë si valltar në festivalin e pionierëve të Vlorës. Në vitet 1951–1955 kreva gjimnazin "Asim Zeneli" në Gjirokastër. Në çdo shkollë dola me rezultate të mira. Në 1952-in mora pjesë si vullnetar në "Rrugën e Dritës" në Ferr–Shkopet–Mat. Gjatë viteve të gjimnazit mora pjesë në grupe vullnetarësh në ndihmë të bujqësisë, në veprimtari kulturore nëpër fshatra, në grupin letrar si edhe në grupin e gazetës së murit të klasës e të gjimnazit. Çdo vit u zgjodha anëtar i byrosë së organizatës së rinisë në klasë. Kam luajtur tricë, shah, kaladibrançe, kukamëshefthi, në kolovarse, volejboll. I kam rënë pipëzës, culës e longarit. Kam notuar mirë dhe kam bërë udhëtime në pyje e male. Kam fjetur në stane, kam qenë çoban me kecër e lopë. Kam transportuar me mushkë shtylla për minierën e Selenicës. Në fshat jam rritur me ngrohtësinë e gjyshes e të nënës, me vëllezër, me motra e kushërinj. Kam shkuar mik me gjyshen e të tjerë në disa fshatra në bregdetin e Himarës, në gëzime e në hidhërime.

Këto vite jete më rritën, më poqën para kohe e më burrëruan më shpejt, pra u bëra ky që jam, duke ia kushtuar gjithë jetën

mbrojtjes së Atdheut dhe kombit tonë, duke luftuar armiqtë e shumtë si atdhetar, diplomat e zbulues. Jam krenar për LANÇ-in, ku ranë dëshmorë dy kushërinj, njëri djalë i vetëm, Rrapo Luçi, në 1944, Jashar Luçi në 1943, dhe vëllai i këtij të fundit, në luftë me diversantët në vitin 1949 në Krujë, Heroi i Popullit, Nuri Luçi.

Parathënie

Kam menduar gjithnjë të shkruaja kujtimet e mia, sidomos për profesionin e zbuluesit, por për arsye sekreti nuk mbajta ditarë të rregullt, sepse mendoja që do të më duhej të përdorja dosjet përkatëse në arkiv. Në atë kohë kurrë nuk mendoja e as dyshoja, të paktën deri në kohën kur vdiq Enver Hoxha, se do të përmbysej pushteti popullor. Më pas u kuptua se vendi do të tronditej këtej e tutje, pasi në fund të viteve '70 u prishëm me Kinën, e sidomos në vitet '80, kur filloi dhe u rëndua kriza ekonomike në vend, pa përjashtuar gjendjen e "Luftës së Ftohtë" dhe kursit politik të Ramiz Alisë me flirtet me Perëndimin, duke filluar me Greqinë, Gjermaninë etj. Që kur më transferuan në Filialin e zbulimit në Linz të Tiranës në shkurt 1985, hodha disa shënime, me një kod sekret emrat e pseudonimet e ish-bashkëpunëtorëve, e tjera çështje sekrete. Këto shënime i pasurova herë pas here me kujtesë dhe nuk i mbajta në shtëpinë time, por te vjehrra, anëtare partie, e cila i ruante në mënyrë sekrete. Ruaj vetëm fletoren e punës në organizatën bazë të partisë të viteve 1977–1985, që nuk e dogja me procesverbal, siç ishte rregulli me blloqet e punës operative.

Vendosa t'i botoj sot këto kujtime, pasi jo vetëm sepse punova në zbulimin politik shqiptar, pa ndërprerje nga 1955–1991, por edhe pse historia e kësaj arme, krahas asaj të Sigurimit të Shtetit (kundërzbulim e zbulim - OSSh), është përfshirë në debatin e hapur e të rëndësishëm qysh nga viti 1990 dhe nuk mendohet të pushojë mes palëve, brenda vendit, dhe në lidhje me "Luftën e Ftohtë" 1945-1992.

Sigurisht lënia e këtyre kujtimeve, të paraprira nga intervista dhe shkrime, në mediet e shkruara e pamore (televizive) do të nxjerrë në dritë çështjen e ruajtjes ose të shkeljes së sekretit shtetëror, dokument që e kam firmosur edhe unë, si të gjithë ata që punuan në OSSh. Jam i ndërgjegjshëm se sot në tranzicionin e tallazeve çmendarake me vitrinë demokrate, me ndonjë

përjashtim për bashkëpunëtorët e rinj në moshë, nuk do ta respektoj rregullin, pasi PD-ja blu, e të tjera parti e persona antikomunistë, tradhtarë e spiunë, të agjenturave të huaja armiqësore, i dhunuan në mënyrë të skajshme arkivat sekrete të PPSh-së e MPB-së (OSSh, përfshi zbulimin), me dy qëllime: së pari, për të akuzuar e denigruar regjimin komunist (socialist shqiptar në fakt), përfshi LANÇ-in, dhe së dyti, për ta cilësuar punën e OSSh-së antidemokratike, armiqësore dhe për t'u hakmarrë ndaj punonjësve të OSSh-së dhe bashkëpunëtorëve të tyre, por edhe për t'ua ndaluar këtyre punonjësve veprimtarinë politike zyrtare e shoqërore në vend. Kjo punë, antikombëtare dhe antihistorike në thelb, mohon OSSh-në dhe punën e saj historike si organ i çdo shteti në botë dhe hesht për organet e këtij lloji, heshtje e krijuar nga Partia Demokratike që nga viti 1992. PD-ja veproi zi e më zi në këto vite tranzicioni dhe për këtë arsye, ajo dekonspiroi të gjithë punën e OSSh-së në çdo sektor e drejtim, duke i nxjerrë në pazar e duke ua shitur të huajve edhe dosjet e OSSh-së, si edhe arkivat sekrete shtetërore, pa të cilat nuk do të ruhet apo shkruhet më tej historia e veprimtarisë së tyre nga vitet 1943–1992, pasi edhe varianti i parë i historisë së OSSh-së, shkruar nga Themi Bare u ndryshua prej tij me urdhër nga lart pas goditjes së M. Shehut, K. Hazbiut, F.Shehut etj., duke humbur mjaft ngjarje e aksione të autorëve të vërtetë historikë, pasi në tërësi, në variantin e dytë, përmenden fare pak kundërzbulues e zbulues për punën e tyre me vlera në vite. Materiale sekrete iu dhanë edhe I. Kadaresë, i pagëzuari Kadare, gjoja disidenti blu, të dhëna që i përdori në " Koncerti në fund të dimrit" etj., si dhe gazetarëve e analistëve blu, ish të burgosur ose jo, të cilët që nga viti 1992 po mbushin mediet e ndryshme, faqe të tëra me histori sekrete, emra bashkëpunëtorësh, objektesh e subjektesh operative, mjetesh, metodash e forma pune të OSSh-së, përfshi ato të proceseve hetimore e gjyqësore në vite. Kulmi i kësaj demokracie u arrit nga komisioni parlamentar i vitit 1993–1994, i cili kontrolloi punën e SHIK-ut dhe nxori në pazar, nga faltorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë një pjesë të mirë të informacionit

të këtij shërbimi, duke e klasifikuar jashtë çdo rregulli e ligji arkivor shtetëror dhe duke e dëmtuar pa kthim historinë reale të shërbimeve sekrete të vendit tonë, gjatë viteve 1943–1990, të cilat kishim si detyrë kryesore mbrojtjen, rendin dhe sigurimin e pavarësisë së Atdheut.

Unë nuk do të ndjek modelet e këqija të tranzicionit, qoftë nga zyrtarët, politikanët e nga mediet e shkruara e pamore, por arsyetimin atdhetar: së pari, duke mbrojtur interesat e Atdheut e të kombit tim, duke denoncuar pa mëdyshje armiqtë e bashkëpunëtorët e tyre tradhtarë brenda e jashtë vendit; së dyti, do të përmend ata bashkëpunëtorë atdhetarë që i kanë shërbyer Atdheut, që kanë vdekur ose janë në moshë të thellë për t'i nderuar e shpërblyer të paktën moralisht, si atdhetarë të ndërgjegjshëm e të përkushtuar që i kanë dhënë sado pak ndihmesë Atdheut, për ta mbrojtur nga armiqtë e keqbërësit dhe që rrezikuan jetën apo që janë vrarë nga armiqtë. Nuk do të zbuloj identitetin e bashkëpunëtorëve relativisht të rinj në moshë. Në këtë mënyrë, nuk dua të rrezikoj jetën e tyre nga ndonjë çmenduri hakmarrëse e ndonjërit që betohet për atdhetari, kur ka kryer krimin e spiunazhit a vepra të tjera, ndaj Atdheut e popullit të vet, për hesapet e veta e të padronëve të vet. Gjykoj se nuk ka rrezik hakmarrje pas kaq vitesh, nisur edhe nga përvoja e vendeve të tjera, kur nga të dyja palët po mbrohen edhe bashkëpunëtorët e tyre, bile e djathta po shkruan libra, duke i lavdëruar e shenjtëruar bëmat e sërës së saj fashiste, tradhtare, vrastare e spiunimit gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe të diversionit e spiunimit pas çlirimit, duke i dekoruar e ngritur edhe përmendore. Mjafton të lexoni kujtimet e dëshmitë e Xhafer Devës, Ndue Gjonmarkajt, Ali Këlcyrës, Xhelal Staraveckës, Nikollë Mëlyshit, Hasan Dostit, Tahir Kolgjinit, Faik Qukut, Tahir Zajmit, Dr. Xhevat Repishtit, Avdul Banushit, Nafi Cegranit, librat e bardhë titistë, librat e misionarëve anglezë gjatë Luftës së Dytë Botërore, Julian Amery, Nicolas Bethel etj., por dhe arkivat sekrete që janë hapur e po hapen në vendet ish-aleate a armike të kohës, siç janë bërë të njohura edhe nga shkrimet e Auron Tares e të

tjerëve, studiues e historianë në shtypin tonë vitet e fundit nga arkivat e CIA-s e IS-it anglez etj. Këto nuk duan komente, ashtu si nuk duan emrat që ua vunë rrugëve, dekorimi i priftërinjve e diversantëve e shumë të tjerëve nga S. Berisha, B.Topi, F. Nishani etj., lavdërimi i disave nga Edi Rama etj., një turp i pashlyeshëm i demokracisë shqiptare, shkatërruese e traditave, vlerave kulturore e pasurove dhe historike të vendit dhe kombit tonë.

Ky qëndrim i veçantë i imi u intereson të gjitha palëve, pasi edhe CIA, IS, UDB, QIP, SISMI, e tjera zbulime armike e kundërshtare, po h apin e do të hapin kohë pas kohe dosjet e veta arkivore. Kjo u intereson edhe atyre që u persekutuan me të drejtë në regjimin komunist se tani përfitojnë alibinë për t'u hequr si atdhetarë. OSSh-ja sigurisht rrjetin e vet sekret e pati te këto kontingjente armiqësorë, tradhtarë e kundërshtarë, të spiunazhit armik apo antikomunistë e keqbërës. Edhe zbulimi ynë u fut ligjërisht në familjet dhe lidhjet e këtyre objekteve armiqësore, për t'i përpunuar nga brenda, për të parandaluar, zbuluar e goditur veprimtarinë armiqësore të tyre së bashku me padronët, nga brenda e jashtë vendit.

Në kujtimet e mia, që tashmë i kam bërë të njohura dhe në këtë libër, do të jem sa më i saktë me kujtesën time, meqenëse nuk më lejohet të rishikoj dosjet përkatëse, nëse janë të ruajtura. Në fakt dyshoj shumë, sepse kam të dhëna, që një pjesë e tyre janë shitur, mbi të tjera kanë vënë dorë si me dosjen sekrete, Sh.Sh., e të tjera, por edhe me dosje të punës sime, si p.sh dosja e bp "75", "86" etj., që i kanë në shtëpi dhe me të cilat kanë dashur të bënin film me Hollivudin. Do të zbuloj emrat e atyre bashkëpunëtorëve që do t'i quaj edhe të dobishëm për opinionin publik e familjet e tyre, që të mos mbetet anonime puna dhe e tyre për mbrojtjen e popullit dhe të kombit shqiptar. Në fakt, siç u trajtua çështja e dosjeve nga PD-PS, nuk ka mbetur ndonjë gjë sekrete, që unë apo kolegët e mi të zbulimit dhe OSSh-së të ruhemi se mos nxjerrim sekrete shtetërore, sepse në fakt është bërë tashmë nga disa persona, por më shumë nga kundërshtarët demokratë. Politika e këtij tranzicioni zbardhi gjithçka për të

fituar kapital politik, për gjoja demokracinë e kulluar, por në fakt kërkoi të vinte vetulla dhe nxori sytë, sepse i diskreditoi më tej bëmat e armiqve e tradhtarëve, si dhe veten e kthyen mbrapsht në krim njerëzor me bëmat deri sot dhe me sa duket po i thellojnë marrëzitë kapitaliste, feudale e skllavopronare. Nuk kam pse t'i marr në varr çështje që janë tashmë pasuri e popullit dhe e kombit tonë, si dhe kur problemi u bë si puna e strucit. Do të tregoj kryesisht ngjarje dhe personalitetin e bashkëpunëtorëve siç janë zhvilluar dhe siç i kam njohur gjatë punës reale, megjithëse, ndoshta do të gaboj në ndonjë hollësi, por jo në thelbin e tyre, se jam larguar nga puna reale në shkurt të vitit 1985. Pra, çka do të kujtoj janë të vërteta e të sakta. Këtë do ta vërtetojnë, jo vetëm dokumentet që ruhen ende në arkiva të shtetit a private, që një ditë do të hapen normalisht, por edhe nga dëshmitarët e kohës, të cilët janë ende gjallë dhe që edhe mund të shkruajnë apo të japin mendime, siç ka ndodhur tashmë me kujtime e mia në medie që janë pritur mirë.

Detyrohem të shkruaj se pas 1990-ës, për veprimtarinë e shërbimit sekret në tërësi, por të vendeve ish-socialiste në veçanti, përfshi Shqipërinë, dhe sidomos për këtu, janë krijuar mendime pa fund e vlerësime jo të sakta, jo reale e të skajshme, nga politikanët partiakë paskomunistë e kalemxhinjtë e përdorur për ta tjetërsuar punën reale të shërbimeve sekrete në tërësi dhe për ta bërë tejet të urryer pushtetin popullor (komunizmin) që t'i zbardhet faqja kapitalizmit, sidomos diktaturës së egër të tranzicionit në Republikën Shqiptare, të ashtuquajturit demokrat, pa çka se kanë të njëjtin surrat. Sot flitet vetëm për spiunazh dhe nuk bëhet dallimi i domosdoshëm, siç e ka bota mbarë: puna e shërbimeve sekrete e bashkëpunëtorëve të tyre për të mbrojtur Atdheun, që është detyrë, nder e lavdi për vendin dhe ata që i shërbyen, ndërsa për ata që kryen veprimtari tradhtare kundër Atdheut të vet, është poshtërsi e spiunazh i urryer nga njerëzit normalë, që duan dhe mbrojnë interesat atdhetare kombëtare dhe përparimin shoqëror kudo në botë.

Shërbimet sekrete të OSSh-së nga vitet 1943 - 1990, në kushtet e "Luftës së Ftohtë", siç është bërë e njohur herë

pas here, në procese gjyqësore kundër armiqve, diversantëve e agjentëve, në radio, filma, libra e artikuj, bënë një punë shumë të dobishme e vetëmohuese për mbrojtjen e interesave kombëtare të popullit tonë që të punonte e të jetonte i lirë. Kjo i shërben Atdheut dhe historia do ta çmojë e vlerësojë, dhe do të shërbejë si shembull për brezat e rinj në të ardhmen. Por nuk duhet të harrojmë e ta mbulojmë, në kohë të ndryshme, ndonjë fakt se drejtues të veçantë të shërbimeve sekrete apo agjenturistë ekstremistë, të paaftë ose të nxitur nga gabimet e vijës politike të asaj kohe për luftën e klasave, si edhe punonjës me orekse servile e karrieriste, kanë bërë gabime, teprime e faje ndaj njerëzve të pafajshëm, por kjo s'ka qenë vijë partiake a shtetërore, fakt që e dëshmojnë platformat e punës dhe rregulloret, të cilat ndoshta ruhen ende në arkiva. Politika e PPSh-së, e mbrojtur nga E.Hoxha deri në fund të jetës së tij, bëri që lufta e klasave me eufori të ashpërsohej. Çështje të vlerësuara jo saktë shkencërisht, bënë që të krijoheshin edhe gjendje pa arsye bindëse, të cilat çuan në zgjerimin e mëtejshëm të luftës së klasave deri në kushërinj të tretë e më tej, kjo shtoi rrethin e të deklasuarve e të të përndjekurve, gjë që krijoi me të vërtetë probleme serioze për rrethin e të dënuarve dhe për shoqërinë në tërësi. Kështu, gabimet dhe fajet nuk u personalizuan realisht, si thotë populli nuk shkuan te dora vetë, por përkundrazi u zgjerua rrethi që përfshiu edhe njerëz pa gabime e faje, të cilët u cilësuan si të dyshimtë, dhe nuk iu dha e drejta për të bërë sqarimet dhe shfajësimet e domosdoshme.

Qysh i ri, gjatë periudhës së "Luftës së Ftohtë", punova kundër të dyja kampeve armike e kundërshtare, për të mbrojtur Atdheun e kombin tim si ushtarak deri madhor, si qytetar që kisha bërë betimin ushtarak për flamurin e kombin, për të mbrojtur interesat e vendit tim, dinjitetin si ushtarak përballë provokacioneve, kërcënimeve të hapura e të fshehta, propagandës armiqësore, provokacioneve etj., ndërhyrje në punët e brendshme të vendit socialist shqiptar e të kombit tonë. Kjo nuk ishte barrë e lehtë, por bëra atë që bëri çdo ushtarak, çdo qytetar i RPSh-së dhe çdo shqiptar atdhetar, në trojet etnike dhe

në diasporë. Vura në veprim të gjitha energjitë e mia mendore e fizike edhe duke rrezikuar: do jepja edhe jetën në rast nevoje me përkushtim, siç bënë dëshmorët e Atdheut në çdo kohë.

Puna, si zbulues e diplomat, më rriti përkushtimin e përgjegjësinë, dashurinë e madhe për profesionet e mia, pra u mundova t'i justifikoja me korrektësi e drejtësi, kështu që më rritën, më formuan dhe më bën ky që jam sot. Këto punë japin kënaqësi të jashtëzakonshme e të ngjitin edhe në maja, kush punon pse jo, për t'u ngjitur edhe në këto maja. Këto punë më kanë mbushur shpirtin, më kanë lumturuar, më kanë bërë të njohur, shumë njerëz në rrugë më respektojnë, më kërkojnë të shkruaj dhe këtë po e bëj herë pas here. Punoj i gjallë, më mbajnë gjallë përshëndetjet e njerëzve, mirënjohja e tyre, përfshi edhe e atyre me të cilët kam punuar në vite brenda e jashtë vendit, shqiptarë e të huaj. Kështu më lehtësohen edhe hallet e mangësitë si pensionist,, që "demokracia" na ka halë në sy se ruajmë dinjitetin e s'bëhemi lepitka të borgjezisë si politikanët e lukunia ujkore e tyre në këtë tranzicion faqezi. Kapitalizmi flet ende për një botë të re demokrate, por në fakt zbaton varfërinë mjerane për popujt dhe ne shohim vetëm rritjen pa fre të të pasurve, globalizimin e botës në kriza të vazhdueshme e pa mbarim, gjithnjë në përkeqësim. Shqipëria socialiste nuk u krijua nga frika, por nga vullneti i popullit për liri e pavarësi gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe pas fitores, pra Republika Popullore e Shqipërisë, ishte me të vërtetë një botë e re. Pikërisht për këtë arsye borgjezia propagandon banalizimin e "njeriut të ri", realizmin socialist etj., në socializëm se ishin njerëzit normalë, qytetarët atdhetarë, që u kulturuan e përparuan pasi dolën nga jeta mesjetare. Realizmi socialist kishte censurë për gjithë prapësitë feudo-kapitaliste që, siç po shohim sot, botojnë e tregojnë të gjitha poshtërsitë, trafiqet dhe krimet më monstruoze, nxitet hakmarrja, vetëvrasja, hajdutëria, prostitucioni, pedofilia, krijohen rrjete mafioze, përgjohet gjithkush, rifilloi analfabetizmi, elita kapitaliste korrupton të rinjtë me vese, lejon me ndërgjegje papunësinë, varfërinë dhe jetesën e njerëzve rrugëve etj., tragjedi e komedi njerëzore, siç po ndodh sot në të gjithë botën.

Shteti socialist, populli më dha shtëpi e poste zyrtare, nga një falënderim e fletë nderi, ndonjë dekoratë, por jo shpërblim të merituar se ashtu ishte koha për të gjithë popullin, i cili ngjiste rrugët e përparimit me mundime e sakrifica. Por, tranzicioni demokrat, kapitalizmi, tregu i lirë, na harroi fare sikur s'kemi qenë qytetarë të përkushtuar e të nderuar për vendin e kombin. Dekoratat e fletënderet janë nëpër sirtarët e shtëpisë. As ministritë përkatëse, ku punova, nuk kujtohen sot për asnjërin nga ne, nëse jemi të gjallë apo jo, por edhe ne nuk ua japim atë kënaqësi që duan, t'u bëhemi ferrë për ndonjë përfitim. Mezi na u dha, me shumë vonesë, një pjesë e vogël e pensionit ushtarak, që na takon katërçipërisht, se kemi derdhur të hollat, sipas ligjeve të kohës për pension pleqërie, që po na e ha një pjesë e shtetit hajdut. Shteti demokrat s'ka hyrë kurrë në hallet dhe problemet tona, kuptohet që, pa tjetër, edhe hakmerret, sipas urdhrave edhe të huajve, që komplotuan e komplotojnë ende kundra shqiptarëve atdhetarë, Atdheut dhe kombit tonë. Nuk u duhemi as për nevojat e autoritetit politik para botës, se nuk i miratuam të çmendurit në vite, pra ky s'është as shtet ligjor, as demokrat dhe s'ka për t'u bërë kurrë, me këto veprimtari klanore krahinore, bajraktare, fisi e familjare, me krime të organizuara e i korruptuar deri në palcë, me veprimtari antikombëtare e mafioze ndërkombëtare, duke shitur edhe territore të reja të RSh-së si detin Jon, veç trojeve tona, për të cilat s'u kujtua qysh prej fillimit të pushtetit rozë e blu, me veprimtari fashistizuese, se nuk vepron për asgjë pozitive për vendin e kombin, për përparimin e popullit, që i ktheu në mesjetë me shkatërrimet masive e rrënjësore të arritjeve gjatë periudhës socialiste, vepra të krenarisë e lavdisë së punës së popullit shqiptar pas çlirimit. Profesionet tona u katandisën për faqe të zezë për derisa u emëruan në ministritë, ministra politikë që shkatërruan vlerat e shtetit ligjor në të gjithë vendin, duke rivendosur tregun barbar kapitalist, me rregulla e ligje mafioze, ku njeriu trajtohet si mall tregu pa vlerë. Më dhëmb shpirti për popullin që vuan përgjithnjë mungesën e një shteti të fuqishëm ligjor, i cili të jetë në shërbim të qytetarëve të tij e jo të kapitalit vendës e të huaj,

pra thjesht koloni. Ky shtet, mbetet i dobët, i pafuqishëm, para krimit për faj të politikës së brendshme dhe forcave armiqësore e mafioze që veprojnë edhe nga jashtë kundër RSh-së e kombit shqiptar. Çfarë nuk na dëgjon veshi, çfarë nuk na shohin sytë, për ditë e net, qysh nga viti 1990 e deri sot, pas përmbysjes së shtetit socialist ligjor, pavarësisht të metave të tij, nga çlirimi deri në fund, si kudo gjatë rrugës me plot të panjohura të shumta dhe mundësi të pakta e të kufizimeve të detyruara. Edhe pse u çlirua Kosova, u ndalua bashkimi me Shqipërinë nga ndërkombëtarët dhe marrëdhëniet ecin ngadalë, në vend që të bashkëpunohet e bashkëveprohet për përparim. Ende Serbia dhe shtete të tjera nuk duan ta njohin Kosovën si shtet dhe më e keqja nuk po bëhet asgjë për të korrigjuar padrejtësitë historike ndaj kombit tonë nga fuqitë e mëdha dhe fqinjët tanë shovenë.

Edhe pse, shteti demokrat na diskreditoi me ndarje politike e fshirje identiteti e personaliteti me nenin 24/1, ne mbijetojmë në xhunglën dhe injorancën, keqdashjen e padrejtësitë "demokrate", se ne jemi fisnikëruar me punën atdhetare shumëvjeçare të shoqërisë socialiste shqiptare. Gjithë jetën, e në veçanti rininë e shkrimë nëpër sakrifica në vepra me vetëmohim e përkushtim atdhetar e njerëzor, si njerëz të kulturuar e të përparuar, jo si militantë fanatikë, llum e të korruptuar të administratës së sotme "demokrate" dhe e prirë vetëm për të mjelë e rrjepur shtetin dhe popullin.

Në këtë tranzicion shqiptar, jam i ngarkuar me mesazhe, siç është vetë jeta ime, për të bërtitur fort në këtë kohë kaq të turbullt, për të shprehur pikëllimin e madh që na ka ndrydhur e shtrydhur në këto 30 vjet, në atë masë sa më dhemb thellë në shpirt e në zemër fati kaq i mbrapsht i shqiptarëve në shekullin e ri, të vetëquajtur demokraci. Kjo, së pari, për vet fajin e shqiptarëve të përçarë, por dhe kundërshtarë me njëri-tjetrin, pa miq të vërtetë rreth nesh e larg, përkundrazi nën trysnitë e mërgimit pa fund, biblik e të asimilimit në diasporë, që enden si re nëpër kontinente.

Këto kujtime të miat thërrasin vigjilencë dhe gjithmonë vigjilencë: o shqiptarë, që kemi një gjak e një farë, hapni

sytë, bëjini mirë llogaritë për mirëkuptim e bashkim, braktisni përçarjet, hakmarrjen, bëni pajtim e kulturim bashkëkohor! Kujtime e mia janë si dëshmi për të mos heshtur dhe për të vepruar në interes të vendit e të kombit, pa pasur frikë nga përgojimet, që na bëjnë si nacionalistë, nga ata që ia kanë shitur shpirtin djallit e të huajit për dy groshë. Të luftojmë forcat mesjetare e mafioze që sundojnë vendin e kombin shqiptar dhe forcat e huaja kundërshtare në çdo fushë e drejtim të vendit.

Falënderoj Ilir Balilin, ish-kryetar dege i nderuar, kundërzbulues, Dilaver Goxhajn zëvendëskomandant i UÇK-së e Kolë Gjonaj, zbulues i mirënjohur, të cilët pasi u njohën me këtë libër më dhanë edhe këshilla të mirëpritura.

Si u përfshiva në shërbimin e zbulimit politik shqiptar

Ditët e fundit të qershorit të vitit 1955, pasi mbarova me rezultate të mira gjimnazin "Asim Zeneli" në Gjirokastër, pa u zbardhur mëngjesi, u nisa për t'u kthyer në vendlindje, në fshatin Kuç të Labërisë, jo nëpërmjet Vlorës, se humbisja shumë kohë për arsye transporti, por me këmbë përmes maleve të Kurveleshit (Gjirokastër, ura e Kardhiqit, Picar, Kolonjë, Golëm, qafa e Gomarthit, Shur i Kuçit), Kuç qendër deri në Rrëzë të Luçe, këtej maleve fqinje me Himarën, ku kisha shtëpinë. U takova dhe po çmallesha me familjen. Fillova edhe punë shtëpiake apo mbartje shtyllash druri me mushkë për minierën e Selenicës. Njëkohësisht prisja edhe një të drejtë studimi për në universitet (pasi kisha kërkuar tri degë, ëndrra të miat rinore: letërsi, matematikë dhe kinematografi), se një bursë për mjek ushtarak, ma kishte premtuar dega ushtarake në Gjirokastër. Pra, në atë shtator do të zgjidhej enigma dhe do të vendosja për degën e studimeve. Nuk bëra asnjë ndërhyrje me miq, se isha i sigurt se do të miratohej njëra prej degëve të kërkuara, sepse pata rezultate shumë të mira, prandaj shkova menjëherë në shtëpi.

Por papritur, pa u çmallur mirë edhe me familjarët, se një pjesë ishin lart në mal për verim, erdhi në shtëpi një polic i lokalitetit të Kuçit, të cilin pasi e pritëm, sipas traditës, na tha mua e babait, se mua më kërkonin në Degën e Punëve të Brendshme në Vlorë, ku duhej të paraqitesha sa më parë. Ai nuk dinte asnjë hollësi tjetër. Pasi iku polici, babai më pyeti, se mos kisha bërë ndonjë gabim a faj në gjimnaz apo gjetkë. E sigurova, se asgjë e keqe nuk më ka ndodhur, sepse nuk kam bërë gjë. Më shkoi mendja, mos duan të më veshin ushtarak, siç më kishin kërkuar që kur isha në fillore e shtatëvjeçare. Mendoja të mos pranoja për arsye shëndetësore, ku kërkesa e parë është shëndeti edhe për një ushtar, të cilit para se ta thërrasin ushtar i bëjnë vizitën. Isha disi shëndetlig, josportiv, siç duhej në ushtri, veç policisë, e cila mblidhte njerëz edhe të dobët dhe me shtat të shkurtër, ndonjë edhe të çalë etj.

Babai më porositi të shkoja në Vlorë, por më parë të takoja vëllanë e tij, Safetin, që punonte në Degën e Punëve të Brendshme, të bisedoja me të, nëse kishte dijeni, pastaj të paraqitesha në degë. Babai më dha dy mijë lekë të kohës, duke menduar se do të shkoja e do të kthehesha shpejt në fshat. Qysh atë pasdite shkova në fshat-qendër te njerëzit tanë dhe u gdhiva te Haxhikë Luçi, nëna e dëshmorit Rrapo Luçi dhe në mëngjes shkova në Vlorë, me postën e udhëtarëve, një kamion i përshtatur, i mbushur plot e përplot me njerëz. Zbrita te sheshi i Komitetit Ekzekutiv, se në Vlorë kisha qenë edhe tri herë të tjera dhe atje pranë ishte shtëpia e xhaxhait. Ora ishte 10:30 dhe rastësisht u takuam me të, në rrugë para shtëpisë së tij.

- Bëre mirë, që erdhe - më tha ai, - a të njoftoi njeri?

- Po, - i thashë, - erdhi polici i lokalitetit.

Shkuam në një kafene. Atje ai më tha se më kërkonte Ministria e Punëve të Brendshme, e cila po mblidhte studentë të mirë me mësime që kishin mbaruar gjimnazet, dhe shkolla të tjera për nevojat e saj, për oficerë të sigurimit, policisë e shërbime të tjera. Disa nga Vlora ishin nisur për në Tiranë, pasi ishin lajmëruar. Ai më tha se nuk e dinte se për çfarë specialiteti më donin, por më kështilloi të pranoja në sigurim (punëtor operativ) dhe jo në polici, se sipas tij, sigurimi është zanat i bukur, se edhe ai merrej me punë operative. Iu përgjigja se nuk kisha bërë ndonjë kërkesë për oficer në MPB apo në ushtri, se nuk doja të vishesha ushtarak për arsye shëndetësore. Këtë e kam vendosur me kohë, i thashë xhaxhait, se nuk kisha fizik për zanatet ushtarake, veçse për mjek ushtarak po, me që do të ma siguronte dega ushtarake në Gjirokastër. Ai më kështilloi sërish, se unë do ta bëja mirë punën e sigurimit, mjafton të ishe i zgjuar, i ndershëm, punëtor, të doje zanatin, që mësohet si gjithë profesionet e tjera. Pasi bëmë disa debate, unë këmbëngulja në vendimin tim, kur ai më tha: - Shko mëso pse të kërkojnë dhe fundja vendos vetë atje! Në ministri, - shtoi ai, - ka shumë kuçiotë, bisedo edhe me ata që i njeh. Veç njerëzve të fisit tim apo të miqësisë sonë, më tha të bisedoja me Bejo Stefanin, ish-kryetar dege në atë ministri, njeri nga fshati që i ndihmonte

të gjithë fshatarët me ndershmëri, sipas mundësive që kishte. Më në fundi thashë se nuk kisha as shumë para me vete për në Tiranë, se babai dhe unë menduam se do të kthehesha në fshat. I tregova sa lekë kisha dhe ai më tha të jap unë, më dha një mijë lekë.

Pasi pagoi kafetë, të dy shkuam në DPB, ku më priti një kapiten i kuadrit, i cili në këmbë, në prani të xhaxhait, më tha se do të shkoja në ministri në Tiranë, se as ai nuk dinte më tej përse më kërkonin. Atë natë u gdhiva te xhaxhai. Të nesërmen në mëngjes, ai më përcolli në agjencinë e transportit, ku gjetëm një kamion, hipa lart dhe më çoi në Tiranë. Atë natë shkova te halla, Nado Luçi dhe i shoqi, Reshat Haxhiaj, në rrugën Perlat Rexhepi, në Tiranën e Re. Biseduam për familjen dhe për çështje të tjera që lidheshin me fshatin tonë. Shkurt u thashë përse kisha ardhur në Tiranë. Reshati nuk dinte gjë, se ai qe berber, por kish qenë partizan dhe mendonte se duhej të pranoja, se sa të prisja të drejtën e studimit në degët që kisha kërkuar, sepse Ministria e Punëve të Brendshme ishte ministri që kishte nevojë për njerëz me shkollë, se shumica, të dalë nga lufta, si ai vetë, nuk kishin as shkollë fillore e jo shkollë të mesme a aq më shumë të lartë. Halla Nado më tha:

- Bëj si të duash, ti i di aftësitë e tua dhe dëshirat, shko ku të pëlqen, se je student i mirë në mësime!

Ndërsa Reshati më tha se para se të vendosja mund të takoja edhe kuçiotë që punojnë atje, si Bejo Stefanin, Resul Skënderin, Faik Lalën etj., të cilët ai i njihte si njerëz të mirë e me aftësi. Po të doja unë mund të më njihte me ta. I thashë se do të paraqitesha si fillim në ministri, pastaj do të shihja si do të shkonin punët.

Në mëngjes u ngrita shpejt dhe shkova në ministri. Sa u nisa, halla dhe burri i saj më uruan : - Ishalla për mbarë! Rreth orës 8 të mëngjesit u paraqita te porta kryesore e ministrisë në bulevardin e madh, afër Sheshit Skënderbej. Kur u hap porta, njoha Asllan Çipën, kapiten, fis i largët. Ai më njohu menjëherë, u përqafuam me mall, se njiheshim herët në fshat. Më pyeti për fshatin e njerëzit e tij, pastaj e lamë të takoheshim pasdite,

kur të mbaronte orari zyrtar. I thashë se duhet të paraqitem në zyrën e kuadrit të ministrisë, se po rrinim në shkallët e hyrjes. U gëzua shumë, e kuptoi se do të veja dhe unë atje, por i thashë se ende nuk di pse më kanë thirrur. Ai telefonoi diku, se shërbente në hyrje dhe pas pak erdhi toger Jorgo Polo nga Qeparoi, të cilin më vonë e njoha mirë dhe u bëmë miq, veç që ishim edhe një fis me prejardhje, ai i krishterë, unë mysliman. Ai më çoi te nënkolonel Halil Pulo, drejtor i kuadrit, në katin e parë, në formë "L" të katit, nga ana e djathtë (atëherë hyrja e ministrisë ishte nga bulevardi, ndërsa më vonë u bë hyrja nga mbrapa, karshi Teatrit Popullor), pastaj anash nga Ministria e Ndërtimit, e përsëri nga teatri ku është sot.

Nënkolonel H.Pulo u ngrit në këmbë, kur togeri më paraqiti dhe buzagaz më dha dorën, më ftoi të ulesha përballë tij. Kështu bëra. Më pyeti për Nuri Luçin, çfarë e kisha, për babanë tim, shkollën që kisha bërë etj., për çka i dhashë përgjigjet e sakta dhe shkurt. Pastaj më pyeti se çfarë dëshire kisha të bëhesha, me qenë sapo kisha mbaruar maturën. I tregova për kërkesat e mia, të cilat i kisha bërë me shkrim dhe isha në pritje çfarë do të më miratohej. Ai qeshi sërish me atë zërin e tij të thatë, si të korbit, dhe tregoi se më kishin studiuar që në fillim të vitit në gjimnaz, për meritat e fisit tim, të familjes dhe për nder të Nuri Luçit, si dhe për cilësitë e mira shembullore në mësime dhe në jetë, prandaj kishin menduar të më propozonin të punoja në Sigurimin e Shtetit në M.P. Brendshme, ku do të bëja edhe shkollë, po aq të mirë, sa edhe shkollat e larta civile. Ai shtoi se ka bindjen edhe si kurveleshas, që jemi, unë do të pranoja. I shpreha falënderimin tim për gjithçka të mirë që tha në adresën e fisit tim dhe mendimet ndaj meje, por i shpjegova pse nuk jam futur në ushtri, pasi kam pasur gjithnjë kërkesa dhe i theksova, se për t'u bërë mjek, qoftë ushtarak pranoj, por jo në shërbime të tjera për arsye të shëndetit tim, jo të fortë dhe fizikut delikat. Ai qeshi përsëri dhe për të më bindur më foli për rolin e Ministrisë së Brendshme në mbrojtje të fitoreve të vendit, në luftën kundër armiqve etj. E falënderova përsëri për propozimin e ndershëm, por përsëri i shpreha të njëjtin mendim

dhe jo se refuzoja shërbimin në këtë ministri, me të cilën më lidhte edhe gjaku i tre kushërinjve të rënë dëshmorë dhe lufta e babait tim e të tjerë nga familja në LANÇ, apo me diversantët pas çlirimit, pasi edhe bursën që pata në gjimnaz, e pata për meritat e tyre. I nënvizova edhe një herë gjendjen time fizike jo të përshtatshme për ushtarak, siç e gjykoja dhe se edhe xha Jaho Gjoligut, gjeneral me këtë arsye nuk ia plotësova dëshirën që në vitet e para pas çlirimit. Më këshilloi të mendoja përsëri dhe të vija të nesërmen, të pyesja edhe bashkëfshatarë në këtë ministri e shokë të tjerë, që tashmë kishin ardhur nga gjimnazet e vendit, të cilët kishin pranuar dhe ndodheshin atje ato ditë dhe që do t'i takoja jashtë ministrisë. Më dha dorën dhe më tregoi rrugën nga erdha. Ky ishte takimi i parë dhe propozimi i parë zyrtar nga kuadri i ministrisë, gjë që nuk më pëlqeu, se nuk më tha gati asgjë konkrete për sektorin ku do të punoja, çfarë shkolle do të bëja, a ishte shkollë e lartë apo kurs i lartë, pra veç në vija të përgjithshme, që m'u dukën, qoftë për arsye sekreti, se mund të justifikonte çdo zgjidhje reale më vonë, për mirë apo disi, për sa kërkoja të studioja. Duke pasur ëndrrat studentore dhe biografinë e përshtatshme pa njolla të çfarëdoshme, si familje dhe unë vetë, vendosa që edhe në takimin e radhës të mos e pranoja.

Kur dola jashtë u kujtova dhe bëra lidhjet për çka më tha nënkolonel H.Pulo, se më kishin studiuar. Në fillim të vitit e pikërisht në janar të 1955-ës, një ditë në gjimnaz, në katin e dytë, në kabinetin e kimisë, më çoi drejtori Vangjel Kostaqi, ku më paraqiti dy persona, pa më thënë emrat e tyre, që në emër të Ministrisë së Arsimit, donin të bënin një njohje të shkurtër me mua, të më pyesnin për probleme rreth shkollës dhe konviktit në tërësi, për punën e rinisë dhe dëshirat tona. Rreth gjysmë ore më pyetën për veten dhe familjen, për Nuri Luçin, etj. U dhashë përgjigjet e zakonshme edhe për dëshirat e mia për studimet e larta, duke u shprehur për letërsinë, matematikën dhe kinematografinë, me qenë se atë kohë merresha edhe me poezi, me gazetën e murit të gjimnazit, isha i mirë në hartime. Dy personat takuan edhe bashkënxënësit Anthokli Kondin,

Gaqo Sheshin, Jorgo Prokon etj., por asnjëri prej nesh nuk e mësoi të vërtetën e këtij takimi, por edhe nuk i dhamë rëndësi. Atëherë kuptova se kandidaturat tona kishin kohë që ishin vënë në studim me një qëllim, gjë që më vonë m'u duk krejt normale, në fushën e përzgjedhjes së kuadrit për një sektor delikat të shtetit.

Pasdite takova Asllan Çipën dhe kujtuam plot njerëz e ngjarje të fshatit – ai dukej tejet i malluar. Për mua ai ishte një burrë i rrallë, babaxhan, i muhabetit, rapsod i njohur, gjithnjë buzagaz, me fytyrë fisnike, bujar i madh. Unë kisha qenë në shtëpinë e tij në Fushë të Bratit, ku kishin mjaft pemë frutore. Asllani ishte njeri shumë i dashur dhe përsëriste shpesh fjalën "xhano", siç thoshin gratë, tregonte bukur histori popullorçe dhe qeshte me lot. Ishte shakaxhi, i thjeshtë, i drejtë, i padjallëzuar dhe gëzohej t'i shihte mirë njerëzit. Më këshilloi të pranoja, duke më treguar edhe ngjarje nga lufta si partizan dhe nga lufta kundër bandave të diversantëve pas çlirimit. Gjithashtu më tregoi se kishte qenë personi kryesor në kapjen edhe të diversantit Et'hem Çako, siç dëshmonin edhe disa bashkëfshatarë, që ishin me të në pritë, përfshi edhe babanë tim. Por kjo meritë nuk iu njoh dhe ai e kërkoi shumë vite, vuajti shpirtërisht, por nuk dimë pse iu mohua ky akt heroik i veçantë, kur u përlesh me të te kroi i Kasemit në Shur të Kuçit. Ai shtoi, se unë isha me shkollë, do të ecja përpara dhe nuk do të mbetesha roje te dera si ai apo bujk e bari si babai etj. Më kujtoi të parët tanë, që kanë luftuar kundër turqve, grekëve e italianëve, që nga koha e Zenel Gjolekës dhe deri vonë, mbetën të varfër e barinj, pa shkollë, por të ndershëm. Ju të rinjtë, tha ai, duhet të na nderoni në shkollë. Më tha se jemi një bark, Çipajt janë më të afërmit me Luçaj dhe kjo është e vërtetë. Atë ditë u gëzova aq shumë me këtë njeri që më dha këshilla prindërore, saqë fjalët e tij më mbetën në kujtesë gjithë jetën.

Pasdite dhe në darkë, folëm përsëri me R. Haxhiaj dhe hallën, të cilëve u thashë se më kërkonin të bëhesha oficer, pa u futur në hollësi, megjithëse s'kisha ç't'u tregoja. Ata ishin dakord të pranoja, se edhe trajtimi ekonomik ishte i mirë dhe

do ta bëja mirë atë punë. Nuk takova njeri tjetër. Atë natë nuk fjeta mirë se problemi im ishte i rëndësishëm, por shkalla e njohjes ishte shumë e vogël për të vendosur, në një kohë që kisha ëndrra për studime të larta të cilave nuk iu trembesha, por si i ri, dëshirat më ftonin në degë thjesht civile.

Përsëri të nesërmen, rreth orës 8 të mëngjesit, shkova në ministri. Atje gjeta një grumbull të rinjsh gjimnazistë, ku njoha vetëm shokun e klasës sime paralele dhe konviktorin Jorgo Proko nga Përmeti, i cili erdhi nga gjimnazi i Shkodrës në vitin e tretë së bashku me Tahir Malon nga Delvina, të dy të transferuar për çështje që nuk i mësova kurrë, por ndoshta edhe se gjimnazi ynë kishte emër të mirë në republikë, sidomos për përparime në mësime, pasi nuk kishim shumë hapësirë për veprimtari të tjera në Gjirokastrën malore, larg detit etj. U njoha aty edhe me vlonjatin Merhamet Hila, vunjotësin Viron Zhebo, fierakët Sokrat Çomo e Kozma Moja, korçarët Servet Backa e Dhimitër Shkodrani, durrsakët Agim Kasa e Mustafa Kadiu, Miltiash Meçin nga Kolonja, Jorgaq Mihalin e Simon Qiricin, që vinin nga teknikumi i naftës etj. Të gjithëve në grup na thirri nënkolonel. H.Pulo, i cili përsëri na foli me fjalë të përgjithshme, por shtoi se kur të pranonim propozimin e kuadrit, atëherë do të na tregonin çështje të brendshme në lidhje me punën, që për arsye sekreti, nuk mund t'i shtjellonin në atë moment. Shumica, kishim mbaruar atë vit gjimnazin dhe ishin me mendimin për të mos pranuar, sepse prisnim miratimet e të drejtave të studimit nga Ministria e Arsimit. Nënkolonel Pulo theksoi se disa kishin pranuar dhe disa të tjerë jo, edhe pse ishin anëtarë partie ose kandidatë, siç isha edhe unë kandidat i pranuar në gjimnaz një vit më parë. Ky cilësim u bë, siç e kuptuam disa prej nesh sepse mund të merreshin edhe masa, nëse nuk do të pranonim, pa përcaktuar çfarë masash. Më në fund na u la edhe një ditë afat për të menduar, jo më gjatë. Kështu dolëm jashtë dhe grupe-grupe bëmë shëtitje, vajtëm në kafene, dhe shprehëm lirshëm mendimet tona, disi mbarë e mbrapshtë si të rinj që ishim, sepse nuk na i bënë qartë me çfarë do të merreshim në ministri apo jashtë saj, por më e rëndësishmja çfarë shkolle të lartë do

të bënim për atë vend pune. Mendohej se mund të shkonim jashtë shtetit, por asgjë e saktë as nga të njohurit, që kishin edhe shokët e tjerë bile edhe vëllezër, në këtë ministri, oficerë të lartë si p. sh. S.Backa, M.Meçi, etj. Mendonim se jo vetëm për arsye sekreti, por edhe për mospërcaktimin e sektorëve të miratuar, ku do të punonim, nuk na u tha asgjë e saktë. Unë u ktheva edhe një herë para drekës që ta takoja edhe një herë xha Asllanin dhe kur po bisedoja me të, kaloi nënkolonel H.Pulo, i cili më thirri përsëri në zyrë, ku më tha se unë duhej të jepja shembullin për arsyet e origjinës dhe qëndrimin e familjes. I kërkova përsëri të na sqaronte mundësisht punën që do bëja dhe shkollën që duhej të bënim, që sigurisht ai i kishte parashikuar si zyrë kuadri. Ai qeshi prapë, duke shtuar se me kohë gjatë punës do t'i mësonim këto. Theksoi se nga unë nuk e priste këtë qëndrim e këmbëngulje dhe shtoi, se ata që nuk kanë pranuar dhe u larguan, mund të mos gëzonin as të drejtën e studimit po t'u dilte. Ky qëndrim i hedhur prej tij, më bëri më dyshues, pra qëndrova sërish në vendimin tim, duke i përsëritur se kisha arsyet e mia që i kam treguar dhe do të kisha bërë shkollën Skënderbej, siç m'u lut xha J. Gjoligu, por unë nuk shkova atëherë. Pas kësaj ai mori në telefon Bejo Stefanin dhe e ftoi të vinte në zyrë. Ai erdhi pas pak dhe nënkolonel Halili ma prezantoi, se nuk e njihja nga afër, megjithëse e kisha parë oficer në fshat në raste festash etj. Xha Bejua më pyeti për familjen dhe si kisha dalë me mësime. Iu përgjigja shkurt. Xha Bejua foli mjaft mirë për babanë tim e vëllezërit e tij, si për kohën në luftë dhe si familje atdhetare, si njerëz të ndershëm e punëtorë, si fis i madh dhe i mirënjohur, veç meritave të Nuri Luçit, dëshmor i Sigurimit të Shtetit apo babait të tij Mustafa Luçit, arsimtar i shquar. - Prandaj e duam edhe ne, sqaroi Halili, të punojë në ministrinë tonë, se kanë ndjekur origjinën dhe rezultatet e shkollës. Ai theksoi se unë nguroja, se kisha dëshira të tjera për studime të larta. Edhe Bejua më këshilloi të pranoja. Më tha, se ishte kryetar dege në ministri. Ai shtoi se unë kisha më shumë shkollë se ai dhe në këtë ministri do të ecja më përpara në punë, ku ka shumë nevoja për gjak të ri.

Përsëri nuk ua dhashë fjalën. Mbetëm dakord të veja përsëri të nesërmen. Kur dolëm nga zyra e drejtorit të kuadrit, xha Bejua më ftoi për kafe, pasi bëmë pak shaka me xha Asllanin. Në kafene biseduam rreth gjysmë ore, por unë qëndroja përsëri në vendimin tim, isha pak i lëkundur, se kisha hallin e shkollës së lartë me profesionet që dëshiroja. Xha Bejua më tregoi se në Ministrinë e Punëve të Brendshme kishte shumë kuçiotë me detyra të ndryshme, veç në sektorët bazë të rretheve të vendit, kështu që edhe nga kjo anë do të kisha ndihmën e tyre, ish-partizanëve të fshatit. Më ftoi të veja nga shtëpia dhe ta takoja përsëri të nesërmen. Më pëlqeu si person i matur, korrekt, i qartë në mendime, njohës i mirë i fshatit, me humor, mjaft i pashëm. Tha se gëzohet që bashkëfshatarët e tij të përparojnë dhe ai vetë i ndihmon shumë për t'i futur në punë, sepse vendi ka nevojë dhe duhet të ndihmojmë njëri-tjetrin. Ai theksoi se në ministri kishte shumë korçarë. Kuptova se edhe në ministri kishte krahinarizma e probleme si kudo gjetkë, siç e kisha vënë re edhe në gjimnaz.

Të nesërmen vajta sapo u hapën zyrat dhe xha Asllani njoftoi xha Bejon, i cili tha të shkoja te nënkolonel H.Pulo, pastaj do të takoheshim bashkë. Ai më priti menjëherë dhe pa më ftuar të ulesha më tha se çfarë kisha vendosur. Iu përgjigja se ende nuk isha i bindur të pranoja se doja të vazhdoja studimet e larta, duke shtuar se shkollat ushtarake nuk cilësohen të larta. - Mirë, more djalë, - më tha, - paske kokë të fortë, unë se mendoja kështu, pa hajde me mua, përfundoi ai, dhe dolëm nga zyra. Afër daljes u ngjitëm në katin e dytë, ku u futëm në një zyrë të vogël. Ai i tha sekretarit, që më vonë e njoha se ishte Myrteza Shameti nga Gjirokastra, që ta njoftonte ministrin, se kishte ardhur ai. Nga kjo kuptova se diçka ishte biseduar më parë, ndofta në mes ishte edhe xha Bejua. Sekretari hyri në zyrën tjetër, që kishte derë mesi, pa dalë në korridor dhe kur u kthye na tha: - hyni! Pasi hymë brenda në një zyrë të madhe, me tavolinë në formë T-je dhe me mjaft karrige, nënkolonel Halili u përshëndet përzemërsisht me ministrin dhe më paraqiti edhe mua me Kadri Hazbiun, që ishte ngritur në këmbë, doli anash tavolinës, ku

rrinte gjatë punës, na dha dorën dhe na ftoi të uleshim. Mjaft i pashëm, ezmer, fytyrë imët, flokëzi, hundë e gjatë e hollë, i gjatë, i dobët, i qeshur, duke hedhur flokët e ballit lart, se i binin mbi ballë dhe dukej se i ishte bërë zakon. Ai më tha shkurt : "Ja dhe unë pa shumë shkollë, jam ministër i brendshëm"; shtoi se quhej Kadri Hazbiu nga Vlora. Tha se nga Luçajt, kam njohur Rrapon dhe gjatë LANÇ-it kam qenë në Kuç. Kam qëndruar në Rrëzën tuaj, te nëna e Rrapos, Haxhika kur isha sëmurë nga të ftohtit, me plevit dhe më veshën edhe lëkurën e dashit derisa u shërova, rreth një javë. Emri i babait tënd s'më kujtohet, por kam njohur mirë Mustafain e nënë Shahon dhe Nuri Luçin më nga afër. Pra duam që edhe ti të ndjekësh zanatin e Nuri Luçit, se partia dhe ministria kanë nevojë për të rinj me shkollë: partizanët e bënë detyrën e tyre. Pa më lënë ende të flisja, më këshilloi të pranoja se edhe shkollën do ta ndiqja edhe punën do ta bëja, siç e bëjnë edhe kuçiotë të tjerë në ministri. Përmendi Bejo Stefanin etj.

E mora fjalën, kur ai bëri një heshtje të vogël, duke mos m'i shqitur sytë dhe buzagaz. Përsëri i tregova rezervat e mia, shkurt siç i kam përmendur. Ai nuk më tha ndonjë gjë shumë të saktë, por i kërkova të më thoshte diçka më qartë për punën dhe shkollën që do të bëja, unë apo shokët, që të vendosnim me dijeni të plot po ose jo. Ai duke bërë një qeshje të zgjatur dhe si pak nevrik, duke i mëshuar fort edhe flokëve të ballit lart dhe duke lëvizur në karrige, sqaroi se nuk do të na merrnin më qafë, po në MPB gjërat nuk i tregojnë më parë, por vetëm pasi fillohet puna dhe kjo për arsye sekreti se ende luftohet me armiqtë e egër e të shumtë. Edhe shkollën do ta japim doemos, por kur të kemi mundësi, pastaj vazhdoi se "Nuk ua hamë llafin. Edhe ti e paske ca kokën të fortë, s'lëshuake pe kollaj, si Rrapua e Nuriu. Jepma fjalën si burrë", - kërkoi në fund. E pashë se ata m'u qepën shumë dhe s'do të më linin rehat. Kështu që i dhashë fund qëndresës sime, sepse mora fjalën e tij të besës, duke u thënë: "Dakord, pranoj, por shkollën do ta vazhdoj pa tjetër, dua që ta mbani fjalën dhe të punoj në një sektor, ku fiziku im të më lejojë ta bëj punën, që nuk e kam frikë, se me punë jam

mësuar, që i vogël, kam punuar edhe në pushimet e shkollës, duke mbartur shtylla për minierën e Selenicës, në aksione kombëtare e lokale, si në hekurudhë, "Rrugën e Dritës", bile kam bërë edhe punë të vështira në fshat". Ata të dy qeshën fort dhe ministri tha me shaka, gjysma e së vërtetës : "Qëndrove gjatë, por u dorëzove, urime, urime"! dhe u ngrit. Unë ia prita sërish: "Po nuk u mbajt fjala e dhënë, iki në një punë me dëshirë". Ai na dha dorën dhe shtoi: "Do të shihemi, tani nënkolonel Halili do t'u tregojë, se kur e si do të filloni punën". Më tha t'u bëja të fala nga shtëpia. Drejtor Halili foli rrallë e pak gjatë bisedës, dukej si nxënës para ministrit. Kështu dolëm nga zyra e ministrit, i cili më la përshtypje të mira për gjallëri, shkathtësi e mprehtësi, mbi të gjitha dallohej zgjuarsia e tij, me sytë shumë të gjallë e zhbirues, për të marrë mendimet pa i thënë tjetri, gjithnjë vrojtues e hetues. Kur u ndamë nënkolonel Halili më tha të shkoja të nesërmen në ministri në mbledhje, me ata që kanë pranuar, për të na njoftuar për fillimin e punës. Ai më tregoi zyrën e xha Bejos, ku shkova dhe i tregova se në bisedën me ministrin pranova. Ai më uroi dhe më tha se "Këtu jemi e do të shihemi". Në dalje takova xha Asllanin, i cili u gëzua që pranova dhe më tha "ishalla të mbajnë në ministri dhe do të shihemi shpesh". Shkova te halla dhe ata u gëzuan edhe më shumë që pranova dhe që do të më kishin afër.

Pasdite takova shokë të grupit të thirrur dhe ata dhe u tregova se pranova në takimin me ministrin, që njihte edhe njerëz të mitë dhe na dha fjalën për të vazhduar edhe studimet e larta. "Na e hodhe ti, - thanë disa, - paske mik të fortë, që të çuan atje". Më vonë mësova se ai kishte thirrur edhe të tjerë, por hëpërhë ata nuk treguan, sepse nuk njiheshim mirë me njëri-tjetrin. Kjo heshtje më la përshtypjen e hidhur për karakterin e tyre, se në fakt nuk kishte gjë për t'u mbajtur sekret. Kjo sjellje dhe gjëra të tjera më vonë, më bënë që të mbaja rezerva me ta, të mos mbaja marrëdhënie shumë të ngushta dhe të mos shoqërohesha shpesh jashtë orarit të punës, sidomos me disa, pa i njohur mirë, se kisha krijuar edhe përshtypje nga gjimnazi për karakteret e njerëzve, sipas krahinave e fshatrave.

Të nesërmen rreth orës 10 të mëngjesit, na mblodhi nënkolonel H.Pulo, neve që pranuam, rreth 20 vetë. Na uroi që pranuam dhe do të ishim më se të kënaqur me punën që do të bënim. Na tha të shkonim të bënim pushimet dhe më 25 korrik të vinim në MPB për të filluar punën, pa dhënë asnjë njoftim tjetër. Ikëm në heshtje, pastaj jashtë filluam komentet.

Të nesërmen në mëngjes u ktheva në Vlorë me një kamion, në një vapë të keqe të korrikut dhe me një palë ndërresa që kisha. Xhaxha Safeti u gëzua që pranova. "Ke bërë mirë, tha ai, do jesh mirë". Të nesërmen gjeta një kamion transporti drush dhe vajta në Kuç. Zbrita tek ura e Laskos dhe me një frymë vajta në shtëpi për të parë ç'do të thoshte edhe babai. Më parë se të shkoja në shtëpi, bëra një banjë, në ngjillin e zakonshëm afër tendës verore të bagëtisë, në shkallën e Gjoshkurtit, por prapë u bëra ujë në djersë, kur u ngjita kodrës nëpër pyll deri në shtëpi, në rrëzë të malit. Në shtëpi gjeta gjyshen Veso, e cila ishte bërë shumë merak, se kishte kaluar një javë, pa asnjë lajm nga unë. Nga ajo kuptova se të gjithë ishin bërë merak. Në darkë erdhi babai dhe mëma. "Po ç'u bëre, më bërtitën ata, s'bëre as një telegram"! U ulëm dhe u tregova sa më sipër dhe kryesorja që pranova të filloja nga puna në Ministrinë e Brendshme. Babai më tha: "Mirë, nuk do të jesh keq, por duhet të punosh mirë, se ka lodhje dhe është punë delikate atje. Po për shkollën ç'do bësh?", pyeti ai. Iu përgjigja se ministri Kadri Hazbiu më premtoi, se do ta vazhdoj, por më vonë, pasi të filloj punën, do ta marr vesh mirë. Mëma ime më tha të mos bëja zanatin e babait me diversantët, se e pësoja si Nuriu, duke treguar shqetësimin e nënës, por "mirë biro, - shtoi, - puno mirë". I thashë, se janë kohë të tjera tani, po edhe atë punë kush do ta bëjë? Ti ke shumë djem edhe po ndodhi gjë, e ngacmova. "Jo, jo, bir i nënës! - tha gjyshja, - kij mendjen kudo nga puna, se puna e shtetit ka rreziqe!" Kështu biseduam vonë atë natë si jo zakonisht, megjithëse do të ngriheshim shpejt në mëngjes për të vajtur në mal dhe në mulli. Të nesërmen ngarkova mushkën dhe shkova në mulli të Shehe në Lumë, për të bluar grurë dhe elb. Kështu vazhdova punët e zakonshme në shtëpi.

Mëma më përgatiste ato pak ndërresa që kisha për t'i marrë me vete. Gjyshja dhe mëma ishin në merak, se prapë do të qëndroja larg tyre dhe mezi çmalleshin me mua. Babai ishte i qetë dhe vetëm 2-3 herë më tha: " kij kujdes, vazhdo mëso, siç ke bërë, pasi ty të ra fati të vazhdosh shkollën, kurse vëllezërit Fadili e Rexhua, do të merren me blegtori e bujqësi, të tjerët po ndjekin shkollën, të paktën do të bëheni të zotë e vetes me shkollë dhe jo si ne pa shkollë dhe në punë të rënda". Vëllezërit e motrat u gëzuan pa masë që do të filloja punën. Kështu pas dy javë pushimesh, u ktheva përsëri në Tiranë, ku hëpërhë, do të rrija me kërkesën e gjyshes, tek e bija, halla Nado, derisa të gjeja hotel apo ndonjë dhomë për të banuar. Kështu me një valixhe të vogël druri, dhe bukë gruri, djathë e revani, ika përsëri nga fshati, pasi u përcolla një copë rrugë nga familjarët, me urimet më të mira.

Hapat e parë në punën zbuluese

Më 25 korrik të vitit 1955 u paraqita në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Neve të grupit të parë, që pranuam kërkesën e MPB-së, na filluan të drejtat financiare qysh më 01.07.1955. Neve, që kishim mbaruar gjimnazin, na u dha grada nëntoger, Na çuan në rrobaqepësinë ushtarake, na qepën shpejt kostumin ushtarak të liridaljes, me shiritin blu të MPB-së. Na pajisën edhe me fletëhyrjet për në ministri. Plotësuam edhe një formular, ku shkruam jetëshkrimin e hollësishëm personal deri te kushëriri i tretë. Bëmë fotografinë për dosjen personale. Nga mesi i gushtit erdhi edhe grupi i dytë, që i filloi të drejtat financiare më 01.08.1955. Na u dha edhe e drejta e kostumit civil: këpucë, çizme dhe ushqime në natyrë, por sipas normës së përcaktuar. Në atë kohë do të rrinim të veshur civilë dhe në raste të rralla me veshje ushtarake, me që ishim punëtorë operativë të Sigurimit të Shtetit (zbulues sekretë). Na bënë emërimet në Drejtorinë e Parë, që ishte ajo e zbulimit politik të jashtëm. Unë u caktova në degën e 6-të të emigracionit reaksionar shqiptar,

siç quhej në organikë. Në muajin shtator filluam rregullisht temat mbi zbulimet e huaja armike dhe emigracionin shqiptar (emigracionin politik, të arratisurit pas 1944-ës), emigracionin ekonomik (kolonitë shqiptare kudo në botë) dhe emigracionin kosovar, nga të gjitha trojet shqiptare në ish-Jugosllavi e Greqi dhe kudo tjetër nëpër botë. Në të dyja kategoritë e fundit, kishte edhe grupime reaksionare kundër pushtetit popullor, veç të arratisurve politikë nga Shqipëria mëmë. Gjithashtu, filluam të lexonim shumë materiale përgjithësuese, relacione, informacione, studime, raporte dhe tema mbi luftën kundër reaksionit shqiptar dhe zbulimeve të huaja armike (amerikan, anglez, grek, jugosllav, italian, francez, gjermano-perëndimor etj.), mbi agjenturat e huaja të demaskuara e të goditura në Shqipëri, për gjyqet e tyre dhe dosjet personale të të arratisurve etj., me veprimtari kundër vendit tonë. Ndër lektorët më të mirë ishin Sali Hoxha e Dhimitër Gjoni, të cilët ishin më të qetë, më të aftë dhe që shkëputeshin nga teksti i shkruar, informonin, shpjegonin dhe trajtonin raste reale, shembuj e plotësime mbi veprimtaritë armiqësore. Më i rrepti dhe më kritizeri ishte Koli Shuke. Kështu, dalëngadalë filluam të njiheshim me punën e ardhme dhe me punonjësit oficerë të drejtorisë sonë, me ata të Sigurimit (kundërzbulimit) dhe me të gjithë kolektivin e MPB-së, si dhe me zbuluesit që ishin diplomatë shërbimi në përfaqësitë tona jashtë shtetit (atëherë legatat, konsullatat, misionet, tregtia etj.) kur ata ktheheshin në Atdhe me shërbime. Në atë kohë u kthye edhe Kozma Shkodrani, të cilit i ishte bërë një provokacion, për faj të tij në Francë. Ai fliste plot mburrje, me një zë korbi, që fliste me r,r,rë dhe, në fakt dukej se ishte tepër i cekët, i lehtë, siç do ta njihnim mirë më vonë.

Unë u caktova në sektorin e emigracionit dhe mbuloja Europën Perëndimore, kryesisht Francën, Belgjikën, Anglinë, Gjermaninë Perëndimore, një kohë edhe Italinë etj. Shefi im i parë ishte major Asaf Kondi, i cili kish qenë me leje dhe u kthye në shtator. Kur i vajta në zyrë, më pyeti nëse e njihja? E shikoja dhe po mendoja ku e kisha parë, por aty për aty nuk m'u kujtua.

"A, kujtesa, - klithi ai, i futur si në rol, kjo është zotësia apo moszotësia e zbuluesit, për të mbajtur mend personat që takon në jetë". Vijoi duke më kritikuar dhe duke lavdëruar veten e tij. Kështu më tregoi se ky dhe Dhosi Progëri, ishin dy personat që na takuan në gjimnazin e Gjirokastrës. Sqaroi se ka qenë shok me Nuri Luçin, në gjimnaz në Gjirokastër. Kuptova se më ka zgjedhur Asafi, pa ma thënë drejtpërdrejt ai vetë. Shtoi se "në këtë sektor kishte shumë punë, se është i gjerë, por që bëhet, mjafton të studiosh e të punosh pa u lodhur". Nuk e zgjata më tej bisedën, se ai vijoi të fliste e të më jepte këshilla. Në fakt me të kalova mirë, megjithëse ishte ironik dhe i rreptë në punë, kërkonte llogari, por edhe vetë punonte shumë, prandaj vendosa të dëgjoja e të heshtja qëllimisht se sa t'i kundërvihesha, e shikoja që i pëlqente vetja, pasi kishte krijuar siguri dhe sillej si kapo me të tjerët. Ishte i shkurtër, truplidhur, zeshkan dhe më tepër qëndronte fytyrëngrysur. Leksionet i jepte mirë në tërësi, por dukej se ishte, siç thuhet, fshatar fodull tipik hileqar dhe shokët e punës nuk e donin shumë, siç kuptohej qartë nga kunjat e tyre për të. Zëvendësi i tij ishte Ropi Llazi (Kote) nga Korça, me shkollë fillore, vllah, me shqiptim tipik, si edhe dy korçarët e tjerë Dhimitër e Kozma Shkodrani, duke theksuar c,c,c-ët, të dy ishin edhe kushërinj. Ropi ishte trupmadh, i shëndoshë, fytyrë gjerë, kishte një dhëmb floriri dhe i mbante buzët të hapura që t'i dukej, por na dukej si azmatik. Ai vinte nga zyra e tij në zyrën tonë, ku ishim 9 vetë, në një dhomë të madhe si sallë në katin e tretë, zyra e dytë që shikonte nga hotel Dajti. Kjo ishte si klasë shkolle dhe Ropi na vinte dalëngadalë nga prapa kurrizit apo para, përkulej dhe na kontrollonte, si të ishim nxënës të fillores, për të parë se çfarë po bënim, domethënë po punonim për sektorin apo po lexonim romane, siç mendonte ai, se veten e quante punëtor të madh. Leksionet i lexonte keq, ngatërrohej dhe ne e bëmë objekt qesëndisjeje këtë e K. Shkodranin. Ne bënin raportet, shkresat e informacionet, siç duhej zyrtarisht në shqip, por ai nuk e dinte gramatikën dhe na i korrigjonte. Një kohë edhe ne ia linim, siç e donte ai, për të mos u gërricur me të kot, se thoshte shpesh ce kështu, ce ashtu. Ia shpjegonim, siç

duhej shkruar gjuha, siç e kishim mësuar, por ai bathë-bathë, këmbëngulte në të tijën.

Në fakt, më vjen ndërmend, pas kaq vitesh se qysh në atë kohë, shpejt nxorëm përfundimin, se ne të rinjtë e punësuar, me shkollë të mesme dhe me gradën nëntoger menjëherë, u pritëm me xhelozi nga oficerët e vjetër që gjetëm atje, të gjithë ish-partizanë, por shumica me arsim fillor, me të mesëm të pambaruar apo krejt autodidakt apo me ndonjë kurs nate, sipas vendit të punës, rrallë me arsim të lartë. Në fakt ata nuk kishin asnjë faj për këtë gjendje, se vinin nga kushte të vështira të jetës familjare dhe të luftës çlirimtare, me ngarkesa pune të rënda e të zgjatura, me disiplinë të fortë, veç halleve familjare. Por, dalëngadalë e kuptuam se ishin edhe xhelozë, dhe ndonjëri kishte frikë se mos i zinim vendin e punës. Kështu u krijuan probleme brezash. Me pak përjashtime si Dhimitër Gjoni, Xheladin Krifca, Sali Hoxha, Andrea Marko etj., të tjerët na trajtonin si çunakë dhe na ngjitën nofkën "neolea" (çunakë) greqisht. Më agresivët ishin Kozma Shkodrani, Koli Shuke, Myslim Sinojmeri, Kopi Niko, Ropi Llazi (Kote), Malo Zahe, Isa Alia, etj. Ne të rinjtë filluam t'i qesëndisnim hapur, kur na ngacmonin për qyfyret që u gjenim gjatë punës në dosje apo kur flisnin gjatë bisedave me ta. Mua më ndodhi një rast tipik. Major Koli Shuke i një sektori tjetër, ngjitur me zyrat tona, një ditë më dha shtambën për ta mbushur me ujë, kur unë do të shkoja të mbushja shtambën time, nga kati i tretë në të parin, se uji s'ngjitej lart. Ai nuk ish as eprori im, por për respekt edhe sikur të ishte, ia mora shtambën. Ai erdhi në zyrë ditën tjetër me shtambën, ma zgjati pa më thënë asgjë. Nuk ia mora, por i thashë të më falte, ta bëra një herë për moshën, por s'jam ordinanca jote për të mbushur katruven e ujit çdo ditë! Unë vetë shpesh i jepja 5 lekë të kohës Bakushes (punëtore rome, rreth 60 vjeçe, me shumë humor) për ta mbushur me ujë. Në fakt po thuaj secili oficer kishte blerë nga një poçe balte (shtambë) për ujë, për ta mbajtur të ftohtë. Koli si me shaka, por i nevrikosur më tha se qenkësha pa respekt për eprorët (majorin mendjemadh), e tjera proçka. Pa u ngritur në këmbë nga tavolina e punës,

nuk i fola gjatë, por i thashë me ti : "e ke gabim, mos u mundo të ma kërkosh prapë këtë shërbim!" Ndërkohë, shoku i zyrës, Jorgo Proko, i tha : "Ma jep mua, ta mbush unë". Majori doli nga zyra, duke shfryrë me kokë varur dhe kurriz të përkulur, siç rrinte zakonisht. Majori u ankua te sekretari i organizatës së partisë, major Andrea Marko, vëllai i Rita Markos, anëtar i BP të PPSh- së. Në thelb Andrea më dha të drejtë. Por, major Shuke nuk zuri mend. Ai filloi të gërricej në çdo rast dhe unë ia ktheja siç e donte. Një ditë më thirri në zyrë major A.Marko, ku ishte edhe major Shuke, i cili në praninë time, iu ankua sekretarit të partisë për mua, duke bërë edhe shpifje sikur të ishte kalama. Ia hodha poshtë ato që tha dhe i thashë troç, se po të vazhdonte kështu, do të shkoja te drejtori, gjeneral Zoi Themeli, në mos më lart te ministri. Major Marko i tha të mos më binte më në qafë. Mua më këshilloi të isha më i butë dhe ta respektoja, si moshë e hierarki ushtarake. Nuk ua zgjata më, por dola nga zyra pa leje. Vura në dijeni shefin e seksionit tim, major Asaf Kondin, i cili në fakt u zu me K. Shuken, duke u acaruar më tej se nuk shkonin mirë. Asafi prerë i tha se s'kishte asnjë punë me vartësit e tij. Në fakt Shuke kërkonte sherre me të gjithë.

Me drejtorin gjeneral Zoi Themelin u njohëm në një mbledhje që bëri ai në shtator, ku na foli për punën që do bënim, na dha këshilla e porosi për sjellje të mirë në jetë, për ruajtjen e sekretit shtetëror në punë, për të bërë një jetë politike të gjerë, për të studiuar e lexuar materialet mbi zbulimet e huaja, të mësonim për interes të punës dhe jetës. Ishte njeri i zymtë, gati i nxinte fytyra, kur qeshte dukej sikur zgërdhihej, fliste pak me ne, na përshëndeste vetëm me kokë kur takoheshim korridoreve ose rrallë herë në zyrë, kur shkonim me shefin për ndonjë problem pune. Me kolegët tanë Servet Backa, Andrea Shkodrani e tjerë korçarë, nuk sillej kështu, ishte më i lirshëm me ta, u jepte dorën dhe bënte muhabet e shaka. Ndoshta se Serveti ishte vëllai i nënkolonel Skënder Backës, shok i ngushtë i gjeneral Zoit, po nga Korça. Kishte të drejtë nënkolonel Bejo Stefani, kur më tha një ditë, se na mbytën korçarët dhe në ministri flitej për "republikën Korça". Në fakt kudo kishte korçarë, oficerë

madhorë, me në krye zëvendësministrin Mihallaq Ziçishti, që silleshin si padronë, pa thjeshtësi dhe me lëvdata, duke pasur haptazi shoqëri lokaliste korçare, se Kolonjën, Devollin e Pogradecin i quanin të dorës së dytë. Tregonin anekdota për ta, gjë që s'ishte normale, kur nuk duhej të kishte të tilla nofka, kur punohej me tjetër frymë pas çlirimit të vendit, se ishin edhe anëtarë partie me përgjegjësi të mëdha në parti e shtet. Në tetor të 1955-ës na u tha se do të shkonim në shkollë të lartë në ish-Bashkimin Sovjetik. Kjo na gëzoi pa masë, sepse do të vazhdonim studimet e larta në një fakultet, pavarësisht, se ishte arsim i lartë zbulimi ushtarak (akademi) dhe së dyti, do të shkonim në BS që atëherë ishte ëndërr e sidomos për të rinjtë, aq më tepër që ne dinim rusisht, se kishim bërë 4 vjet gjuhë ruse në gjimnaz. Mua më caktuan që t'u mësoja rusisht dy kolegëve më të mëdhenj, ish-partizanë e operativë, të dy të martuar, Kiço Remaçka nga Korça dhe Qemal Bajraktari nga Elbasani, pastaj u shtua edhe Fuat Leskaj nga Gjirokastra dhe një tjetër nga Elbasani, të cilit ia kam harruar emrin. Përparimi i tyre ishte i paktë, sepse nuk kishin bazën arsimore, as filloren e plotë, megjithëse u bëja 2-3 ditë në javë nga 2 orë mësim. Kapiten Qemali ishte edhe pak dembel, por shakaxhi i madh, nuk përqendrohej në mësim. Kapiten Kiçua ishte shejtan, hileqar, njeri i cekët e zemërak. Fuat Leskaj ishte bukurosh dhe i qeshur, por dukej qejfli i tërbuar, si edhe elbasanasi tjetër. Të dy këta të fundit nuk vinin në rregull në kursin e rusishtes. Vetë studioja edhe më shumë gjuhën ruse, por te halla nuk kisha kushte, sepse halla kishte një dhomë e kuzhinë të vogël. Doja të rrija në hotel, por ata nuk më linin dhe ua bëra qejfin një kohë, se s'kishin fëmijë. Veç kësaj, burri i hallës, Reshati, më donte si shok: dilnim lulishteve çdo mbrëmje, për të pirë nga një shishe birrë apo të bënim vizita te kuçiotët, mjaft në modë ato vite. Kështu u njoha edhe me shumë të afërm të tjerë, bashkëfshatarë e miq që banonin në Tiranë ose që vinin nga gjetkë, herë pas here, te njerëzit e tyre në lagje e institucione, pasi Reshati kishte shoqëri të gjerë, sepse jetonte në Tiranë që nga çlirimi i vendit dhe zotëronte dhe gjuhë të huaj, italishten.

Në tetor të vitit 1955 na dhanë edhe një copë blu për pallto të madhe civile dimërore, që e qepëm shpejt e shpejt te rrobaqepësit privatë, se rrobaqepësia e MPB-së s'kishte mundësi. Unë e qepa klasike, në një dyqan karshi Librarisë "Flora". J. Proko e S. Qirici porositën një model italian dhe palltot dukeshin ultra-borgjeze, aq sa ne bënim qyfyre me modelin e tyre. Në fakt rrobaqepësi ishte i zoti, por i moshuar dhe gaboi modelin. Një ditë, pasi kishim qenë disa herë për provë dhe po na e vononte qepjen, e gjetëm duke puthur në gjoks një vajzë me perçe, pasi kish harruar pa mbyllur perden pas banakut. Qeshëm shumë me të, por as ai e as ajo nuk u shqetësuan, por vazhduan shakatë dhe vajza iku serbes-serbes. Pasi të gjithë qepëm palltot, në nëntor dilnim si grup me shokë në bulevard për shëtitje në mbrëmje, duke bërë sullaco, siç thuhej, nga dyqani Cingoni, afër monumentit të partizanit dhe deri tek ish-gazeta "Zëri i popullit", si dhe gjatë bulevardit e sheshit "Skënderbej" deri tek Universiteti. Dalloheshim si grup të rinjsh me palltot blu dhe shpejt u mor vesh se ishim kuadro të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Disa kolegë të moshuar, na kritikuan për këto shëtitje në grup të madh, 5-6 vetë, se s'duhej të binim në sy si nëpunës të MPB-së, me që ishim zbulues. Ne vrisnim kohën e lirë si beqarë, pasi në fakt punonim shumë gjatë ditës, deri pasdite vonë në zyrë, pasi kishim me të vërtetë ngarkesë, por ishim edhe kureshtarë të mësonim sa më shumë nga problemet e profesionit të ri: ishim kureshtarë dhe intrigues për çdo njeri. I zvogëluam pak grupet në shëtitje.

Ishte nëntor i vitit 1955, kur shkova në Gjirokastër, në mbledhjen e Komitetit të Partisë për t'u shqyrtuar kërkesa ime, për t'u pranuar nga kandidat, që isha qysh në gjimnaz në anëtar partie. Në mbledhje vajta me sekretarin e partisë të gjimnazit, që nuk e njihja mirë. Kur më erdhi radha, sekretari i KP Kristo Sharra, minoritar grek, më pyeti se ku punoja. Iu përgjigja: "në MPB në Tiranë". Më pyeti për emrat e sekretarëve të KQ të PPSh-së, i thashë dy nga katër. Pyeti nëse e lexoja "Zërin e popullit" dhe për disa artikuj, që nuk i kisha lexuar të gjithë. Më pyeti për statutin dhe pyetjeve iu përgjigja qartë. K.Sharra

ishte pyetësi i vetëm. Ne dolëm jashtë në pritje të vendimit dhe kur mbaroi mbledhja na thirrën brenda. K.Sharra më tha se "isha i ri akoma, të përgatitesha më mirë për AP"! Nuk më erdhi keq, që nuk u pranova anëtar, se do të zgjatej koha si kandidat dhe do të pranohesha pas një viti të shumtën. Por kisha dëgjuar se K. Sharra ishte njeri i rreptë, jo i sjellshëm me njerëzit dhe jo dashamirës me ta, sidomos me lebërit hiqej tepër autoritar. Ai ishte i ngrysur gjithnjë edhe në fytyrë, me tipare greku në lëkurë, flokëbardhë. Pa i përshëndetur u ktheva dhe u largova. Të gjithë të pranishmit në mbledhje më shikuan me habi. Jashtë sekretari i organizatës më tha, se nuk bëra mirë që s'i përshëndeta. I thashë se në gjimnaz dhe në KP ma kanë bërë me hile, edhe më parë, se deshën mos të më pranonin kandidat as atëherë, pa pasur ndonjë arsye bindëse, pa më thënë asgjë, ndërsa pranuan të tjerë sipas planit, bile të dobët në mësime dhe jo me sjellje shembullore. Ai më tha se e kisha gabim, se nuk iu përgjigja për çdo pyetje që bëri Sharra. "Nuk bën mirë, - shtoi ai, - që bën kështu, se punon edhe në Sigurim!" Ia thashë se s'kisha nevojë për moral, dhe ika në hotel, pa ia zgjatur. Të nesërmen u ktheva në Tiranë, por ky udhëtim në Gjirokastër, më la një shije të hidhur. Duke lexuar kujtimet e Flamur Çanit, ish-kryetar i Kom. Ekz. në Gjirokastër, i cili e paraqit më të zi sesa unë K.Sharrën, të cilin e ka njohur gjatë në punë e në jetë. Më vjen mirë që nuk isha gabuar në mendimin tim për K. Sharrën, se sharrë qenkej, dhe mbiemrin nuk e kishte kot.

Udhëtimi Tiranë - Moskë

Muajt kalonin dhe një ditë dhjetori të vitit 1955, na mblodhën urgjent dhe na dhanë lajmin e gëzuar historik, se do të shkonim në shkollën e zbulimit në Moskë. Na porositën ta mbanim sekret dhe të kishim kujdes në çdo hap. Atë natë nuk fjeta pothuajse fare, se më në fund do të vijoja studimet e larta, siç kisha këmbëngulur me kohë. Edhe ministri K.Hazbiu e mbajti premtimin e bërë.

Tashmë grupi ynë prej 25 vetash të zgjedhur, shumica të rinj dhe disa ish-partizanë, tashmë oficerë në shërbim rreth moshës 30 vjeçare, do të shkonim në Moskë për të kryer shkollën e lartë të zbulimit. Ky ishte grupi i parë i zbulimit shqiptar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që do të kryente studimet e larta speciale. Na thanë dhe shkuam grupe-grupe në legatën jugosllave në Tiranë, në rrugën e Durrësit, ku mbushëm kërkesën, për kalim transit me avion nga Beogradi, me legjendën se ishim grup infermierësh për studime në BS. Por e keqja ishte se ne vajtëm atje, me emrat e vërtetë dhe kjo nuk ishte një gjë e mirë. Ua thamë që në fillim shefave tanë, por ata e justifikuan, se ne do të iknim shpejt me avion, pasi nuk priste koha të udhëtonim me vapor, ku sekreti ruhej mirë. Vajtëm dhe e morëm vizën tranzite, të cilën e ruaj ende, ku shkruhet : "ulazi karten (leje hyrje) Hasan Boço Luçi, lindur 01.01.1936, student, shqiptar, rruga Perlat Rexhepi 45 Tiranë, tranzit, pasaportë 04-1206/55, datë 24.11.1955, me fotografi, data 05.01.1956.

Nisja jonë u shty dhe së fundi u vendos që të kalonim një javë, pranë familjeve për vitin e ri 1956. Shkova në fshat në një kohë të keqe, me vështirësi arrita në mbrëmje, vonë sepse më zuri nata dhe nuk shihej rruga nëpër pyje, por isha i ri dhe fluturoja nga gëzimi për shkollën dhe për të takuar familjarët pas 5 muajsh, me familjen kisha vetëm letërkëmbime, me telegrame dhe letra dhe ndonjë lajm nga të njohur që vinin apo iknin nga Tirana. Ishte funddhjetori dhe katër ditë qëndrova në Rrëzë, ku ia kaluam me biseda familjare. Ata ishin të gëzuar, por edhe të malluar e gjithë merak se do të ikja shumë larg, si prapa botës, tha gjyshja. Sidomos, gjyshja dhe mëma vunë merak, por unë i qetësoja. Ditën e fundit therën edhe një dhi, që e poqëm në hell. Mëma bëri arapash e kulaç gruri, revani e djathë, që mora ca edhe me vete. U ndava me ta shpejt në mëngjes, pasi më përcollën deri te lëmi i shirjes së bereqetit; doja të ecja shpejt, të kapja postën (kamionin e udhëtarëve) tek ura e Laskos, arrita në kohë. Atë natë qëndrova në Vlorë te xhaxhai dhe të nesërmen u nisa shpejt në mëngjes me një

kamion dhe mbërrita në Tiranë. Ishte një kohë e keqe, me shi e llohë bore, kohë dimri.

Pasi u mblodhëm të gjithë të zgjedhurit për në ish- BS, na mungonte vetëm një elbasanas që nuk më kujtohet emri. Siç mësuam më vonë nga elbasanasi tjetër Q.B., ai i gjori, nga gëzimi kish mbledhur shokët në një lokal për të festuar, pastaj kishte vajtur në banjë, por si i dehur, atje kish filluar dashuri me romen, punëtoren e banjave publike, ku e panë disa njerëz që e njihnin dhe e dogjën përfundimisht, se njoftuan degën e Sigurimit të qytetit dhe ajo njoftoi ministrinë. Ai u zëvendësua pas 6 muajsh me Mina Shaglën, vëllai i doktorit Shagla nga Tirana.

Një ditë para se të niseshim, na mblodhi në zyrën e tij gjeneral-major Mihallaq Ziçishti, zëvendësministër, i cili me humor të hollë, me fytyrë të qeshur, sikur e pickonte miza, na tha për shaka, mes të tjerash, se atje në Rusi, ku kishte qenë më parë edhe ai vetë me grupin e kundërzbuluesve: shkonin 1-2 grupe nga një vit, duhej të ruheshim nga vajzat, se mos kompromet oheshim, se armiqtë punonin, prandaj ne duhej ta lidhnim "rrushin" me fjongo të kuqe dhe mos bënte gabim ndonjëri të martohej atje, ndonjëri nga ne beqarët e shumtë, se për 4-5 të martuarit nuk kish merak. Qeshëm fort të gjithë, se vërtet mbledhja filloi me gallatë. Pastaj na mbajti një fjalim të shkurtër, mbi nevojën e shkollës, mbarimin e saj më shpejt, se duhej mbaruar normalisht, pra në vend të tre vjetëve, që e bënin sovjetikët, ne do të bënim dy, se vendi kish shumë nevojë për kuadro zbuluesish. Tha se prisnin nga ne rezultate të mira në mësime, pasi ne ishim grupi i parë i zbulimit, që shkonim atje për të bërë shkollën e lartë dhe se shumica dërmuese ishim të rinj me shkollë të mesme. Shtoi se ata prisnin nga ne, të merrnim stafetën në zbulim. Pasi mbaroi fjalën gjenerali, ashtu siç ishim, ai, drejtori i kuadrit, sekretari i partisë së MPB-së dhe ne, shkuam në zyrën e ministrit K.Hazbiu, i cili na foli shkurt në emër të shokut Enver Hoxha e të tij, duke na uruar rrugë të mbarë e suksese në mësime. Shtoi se na prisnin me rezultate të mira në këtë sektor pune. Pasi mbaroi fjalën e rastit,

duke na dhënë dorën, kur u afrua tek unë, më tha duke qeshur: "ja ua mbajtëm fjalën, juve që s'u mbushej koka të pranonit në Sigurim, tani do t'u kërkojmë të lodheni më shumë, se ju e shikoni se çfarë vështirësish kemi në luftën me armiqtë". Buzëqesha dhe nuk shtova asnjë fjalë, se nuk ishte vendi për ta folur më.

Ishim bërë gati me veshmbathjet më të mira civile që kishim dhe që morëm sipas normës ushtarake, përfshi pallton blu të stofit të policisë, me nga një valixhe të vogël në dorë. Na porositën të mbanim edhe kapele, se në Rusi bënte ftohët. Ne bëmë shpejt nga një kasketë vençe, në pazarin e vjetër te kapelexhinjtë. Bëra një kapele gri të errët me vija të holla të bardha, por stof jo i trashë.

Më datën 10 janar të vitit 1956, u nisëm me avion transit Tiranë-Beograd-Budapest-Lvov-Moskë. Avioni ishte sovjetik, rreth 50 vendesh. Në aeroport u përcollëm nga oficerë të drejtorisë së kuadrit, të drejtorisë së zbulimit, pa familjarë, me një autobus të MPB-së. U nisëm rreth orës 10 të mëngjesit. Ishte hera e parë që hipja në avion. Sa filloi të nisej, si grup filluam qyfyret. U lidhëm me rripa. Mbushëm formularët, si rregull i parë për pasagjerët, për evidencë e kontroll. Kur u nisëm koha ishte e vrenjtur. Avioni po ngjitej lart dhe ne shikonim nga dritaret. Shtëllunga resh dhe diku rreze dielli të rralla, Tirana dukej e bukur. Morëm drejtimin e Shkodrës. Pamë Krujën, detin e male. Avioni lëkundej fort se kishte erë. Në Alpet tona, na zuri shiu dhe lëkundjet qenë më të forta. Dukej sikur avioni binte poshtë dhe zorrët na vinin në grykë, por nuk volla. Veshët po më dhembnin nga zhurma. Në ulje në Beograd më erdhi për të vjellë, por shpëtova. Atje nuk dolëm në transit, se avioni nuk qëndroi shumë, ndofta pse ishte me vonesë. Bëmë gati dy orë udhëtim. Pastaj u nisëm në Budapest dhe tashmë e quajtëm veten si të mësuar me fluturim. Lëkundjet ishin më të mëdha në atë ultësirë dhe qyfyret tona u shtuan, por të gjithë ishim mirë. Edhe në Budapest binte dëborë dhe bënte shumë ftohët. Nuk dolëm nga avioni. U nisëm për në Lvov, Kiev, Ukrainë. Lartësia arriti 10 mijë metra. Shikonim vetëm pyje, dëborë.

Qëndruam në Kiev më shumë se një orë dhe hëngrëm bukë në avion, ushqime të thata. Atje bënte ftohtë, koha ishte jo e mirë. Ne i shikonim njerëzit, që na dukeshin si të hutuar, ishin të veshur trashë, shumica ishin të shëndoshë, gratë e vajzat të bukura. Kur u nisëm për në Moskë, Fuat Leskaj desh të fliste italisht me stjuardesën e avionit, një vajzë shumë e bukur, por s'dinte shumë fjalë dhe i ngeli në gojë fjala ma...ma, bene, bene. Ne qeshëm me të. Ajo iu përgjigj përpjekjes së tij për muhabet, ish truphollë e shejtane, sy xixë. Fuati thoshte shqip: "ah, ah, të dija gjuhën, di daja si t'ia çajë ballin!" Ajo na shërbeu mirë gjatë gjithë kohës. Ne bënim qyfyre, shumica flisnin rusisht. Vetëm Miltiadh Meçi e Kozma Moja, ish-mekanikë të Kombinatit Stalin në Tiranë, kishin bërë një vit kurs në Moskë, pra e dinin mirë gjuhën dhe e njihnin qytetin.

Në Moskë mbërritëm në ora 22:30 të asaj dite. Binte dëborë dhe nuk pamë as aeroportin. Kur zbritëm nga avioni bënte ftohtë. Pasi kaluam kontrollin, u futëm në një sallë, me gjithë bagazhin në dorë. Atje nuk kishte dalë ende kush të na priste, veç atasheut tonë ushtarak, Hajdar Aranitasi dhe nëpunësit të ambasadës sonë në Moskë, Zeqi Agolli. Drejtori sovjetik i shkollës, me një veturë dhe me një autobus me zëvendësdrejtorin dhe me një grua erdhën me vonesë. U paraqitën shpejt e shpejt dhe hipëm në autobus. U nisëm, por nuk merrnim vesh në ç'drejtim lëviznim. Në ora një e ca pas mesnate mbërritëm në një vilë, në mes të një pylli, por kishim shumë ftohtë. Pasi zbritëm hymë në një dhomë, që ishte salla e bukës. Atje na uruan mirëseardhjen, na dhanë çaj e bukë dhe gjëra të thata për darkë. Hëngrëm shpejt dhe u shpërndamë nëpër dhoma, sipas një ndarje jo përfundimtare. Ramë e fjetëm si të vdekur, gati të veshur. Të nesërmen u ngritëm dhe pasi hëngrëm mëngjesin u njohëm me mjediset e vilës,. Ishte një vilë mes pyllit të dendur, ku kish qëndruar edhe Stalini gjatë Luftës së Dytë Botërore, pranë rrugës që shkon nga Moska në Minsk, 60 km larg Moskës, pranë qytetit Galicino, deri ku kishte mbërritur ushtria naziste gjermane, që ende në rrethinat e tij dukeshin gjurmë nga rrjedhojat e shkatërrimeve të luftës. Fshati

Siderovsko ishte pak larg dhe më larg një qendër ushtarake. Vila ishte e rrethuar me gardh druri të lartë me tela. Brenda saj kishte terrene sportive, banja. Drejtori i shkollës, Anatoli Ivanoviç, na mblodhi dhe na njohu me të gjithë personelin drejtues: zv/drejtorin Vasili Ivanoviç, personelin e kuzhinës (burrë e grua), pastruesen, shefen e administratës, infermieren, shoferët, rojen (një tartar), personelin e lavanderisë. Ditën tjetër na njohën me mësuesen e gjuhës ruse, Svjetllanën, një grua tejet e pashme, me ca sy të vetëtimtë miqësorë. Më vonë na njohën me mësuesit e gjuhëve të huaja, anglisht, frëngjisht, greqisht, serbisht, gjermanisht, turqisht, italisht. Na njohën me pedagogun e marksizëm-leninizmit, me specialistët e sambos, instruktorët për mësimin e veturës, etj. Gjithashtu, u bë ndarja përfundimtare e fjetoreve. Kështu filluam regjimin ditor 10 orë në ditë, mësim e studim. Pushim vetëm të shtunën pasdite dhe të dielën, por shpesh, o paradite ose pasdite, për liridalje në Moskë ose në qendrat e banuara afër, sidomos në qendrat e vallëzimit të rinisë. Në Galicino shkonim me këmbë rreth 20 minuta dhe prej andej me tren në Moskë. U pajisëm me dokumente sovjetike, me mbiemra të sllavizuar, unë e kisha Ljutikov. Na pajisën me veshmbathje ruse civile të përshtatshme për klimën, pra nuk dallonim nga vendësit, sipas normës së ushtarakëve civilë sovjetikë. Paguheshim si oficerë me 1.100 rubla në muaj, nga të cilat rreth 350 për ushqim, të tjerat për shpenzime personale. Kështu kur dilnim në qytet kishim parat tona, shkonim në kafene, restorante, teatër, opera, galeri arti, parqe etj., veç vizitave të programuara nga shkolla, për t'u njohur me Moskën dhe rrethinat e saj.

Fushat e studimit në fakultetin D të zbulimit

Në fillim, rreth dy muaj e gjysmë, grupi ynë studioi gjuhën ruse, me program të shpejtuar për të gjithë. Iu futa studimit të gjuhës me ngulm, deri në 16 orë në ditë dhe më vonë lexoja çdo ditë. Arrita jo vetëm të kuptoja mirë gjuhën, por edhe të flisja

lirshëm në seminare etj., duke bërë edhe rolin e përkthyesit për disa shokë. Në fakt, ne gjimnazistët përparuam më shumë, ndërsa të tjerët kishin shumë vështirësi, sidomos oficerët më të moshuar të LANÇ-it. Kështu, që për një pjesë, bënim kurs plotësues të gjuhës ruse. Unë i bëja kurs gjuhe K. Remaçkës e Q. Bajraktarit, shokë të dhomës. Dy shokët që kishin qenë edhe më parë në Moskë (K. Moja e M. Meçi), na bënin ushtrime në gjuhën ruse, veç mësueseve ruse, vajza të reja, sa kishin mbaruar universitetin e gjuhës ruse. Njëra nga këto, Alla Nikollajevna, bukuroshe tipike ruse, më thoshte ti je "sllavnij çellavjek" (i shkëlqyer, i mrekullueshëm) se mësoja mirë dhe isha i mirësjellshëm me të, bëja humor, sepse ajo e pranonte me kënaqësi. Një herë i punova një rreng: - kur ajo pyeti shokun e klasës E. Milotin për një fjalë rusisht, ai s'po e gjente dhe unë i pëshpërita: - thuaj "pocelluju vas" (ju puth). Ajo u bë lulëkuqe e i tha: "- çto takoje bjezobrazie" (çfarë thua kështu!). Shoku u habit, s'kuptoi pse i bërtiti, kurse ne të tjerët qeshëm fort, sa u ndje edhe nga dhoma tjetër. Më vonë ia shpjegova psenë dhe u bë si parullë. Jo të gjithë gjimnazistët përparuan njëlloj në gjuhën ruse, për arsye të përzgjedhjes së aftësive, por kishin biografi të mirë dhe besnikëri atdhetare të padiskutueshme.

Pasi mbaruam kursin e shpejtë të gjuhës ruse, dhamë edhe provim, me gojë e me shkrim, filluam lëndët e disiplinës speciale, të zbulimit, të edukimit marksist-leninist dhe çështjet teknike të specialitetit zbulues. Pedagogët e leksioneve, të mbështetur në tekste të miratuara për zbulimin sovjetik, si burra dhe gra dhanë ligjërata cilësore, me përmbajtje dhe formë të lartë intelektuale, me shkrim dhe me gojë. Trajtimi që u bënin çështjeve themelore, sidomos figurës moralo-politike të zbuluesve dhe për metodat e punës agjenturore-operative të zbulimit, shembujt që shoqëronin leksionet dhe ushtrimet, që jepnin për zgjidhje, qenë të cilësisë së lartë dhe të drejtë. Pedagogët qenë specialistë të rangut të lartë, zbulues me përvojë si nënkolonel, kolonel, gjeneral, gjeneral-major etj. Tre nga këta kishin qenë zbulues ilegalë, gjatë luftës në Europën Perëndimore (Austri, Gjermani etj.) dhe në Turqi, ku